



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 33 regjistër (JR)
Datë 12.11.2018

Nr. 32 i vendimit
Datë 21.11.2019

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Ardian Hajdari	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 21.11.2019, ora 11:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 33/2018 (JR), datë 12.11.2018, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Darjel Sina.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 58, datë 01.08.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik M. Muçi, prokuror në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit, gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese në momentin e shpalljes së këtij vendimi.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin

Publik, i cili përfundimisht, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 58, datë 01.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Besnik Muçi dhe shkarkimin e tij nga detyra, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Besnik Muçi, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Ardian Hajdari, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Besnik Muçi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), prej vitit 2002 e në vijim, ka ushtruar detyrën e prokurorit dhe në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë, për rrjedhojë ai gëzonte statusin e magjistratit. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ishte kandidat për Gjykatën Kushtetuese dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 279, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim “ligji nr. 115/2016”), ai iu nënshtroi procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* dhe me përparësi në kohë. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), në seancën e datës 04.11.2019, në bazë të pohimit të subjektit të rivlerësimit, u vu në dijeni të faktit se, me dekretin nr. 11313, datë 15.10.2019, të Presidentit të Republikës, subjekti i rivlerësimit ishte emëruar gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe se më datë 18.10.2019 ishte zhvilluar ceremonia e betimit para Presidentit të Republikës të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Ky fakt është bërë publik në Fletoren Zyrtare nr. 142, datë 22.10.2019, f. 11709.
2. Më parë, në funksion të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - (iv) *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit përcaktoi se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar

formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë, të plotë dhe në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar mbi “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Besnik Muçi”.

5. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “IKLD”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe IKLD-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale) dhe mori vendimin objekt shqyrtimi nr. 58, datë 01.08.2018.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 58, datë 01.08.2018, ka vendosur: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

8.1 Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit, janë konstatuar pasaktësi të vogla në plotësimin e deklaratave të pasurisë ndër vite; ka burime financiare të ligjshme, balancat financiare negative ndër vite janë të papërfillshme në lidhje me intensitetin e të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera; nuk ka kryer fshehje pasurie; nuk ka kryer deklarament të rremë dhe nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

Bazuar në sa më lart, në përfundim të procesit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

8.2 Në lidhje me kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi, është kryer një proces i mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke bërë disa verifikime mbi pastërtinë e figurës, duke hetuar mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në kontakte me persona të papërshtatshëm. Nga hetimi administrativ i kryer, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës si prokuror.

8.3 Në lidhje me vlerësimin në tërësi të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pas rekomandimit të relatorit të çështjes, bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, e konsideron subjektin e rivlerësimit “të aftë”.

III. Shkaqet e ankimit

9. Komisioneri Publik Darjel Sina (në vijim “Komisioneri Publik”) ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 58, datë 01.08.2018, për subjektin e rivlerësimit, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke pretenduar se përfundimet e Komisionit nuk janë në pajtueshmëri me aktet dhe provat e administruara. Komisioneri Publik mban në konsideratë se objekti i vlerësimit të pasurisë, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre dhe i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Si pasojë e këtij detyrimi kushtetues e ligjor, subjektit të rivlerësimit i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi/bashkëpronësi, posedim ose në përdorim të tij, apo të personave të lidhur me të.
10. Komisioneri Publik, ndryshe nga përfundimet e Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në aktet e administruara për këtë qëllim, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të justifikojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, si dhe gjendet në kushtet e mosdeklarimit të tyre, në kuptim kjo të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, kërkoi nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe, në përfundim të gjykimit, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:
- *Ndryshimin e vendimit nr. 58, datë 01.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, zotit Besnik Muçi.*
11. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, për kriterin e vlerësimit të pasurive, paraqiten në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.
- 11.1 Lidhur me pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 57 m², me adresë: rruga “{***}”, Tiranë, blerë me kontratën noteriale të shitblerjes me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 07.01.2006, me vlerë 1.900.000 lekë”, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm, duke mos përmbushur detyrimet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi, sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, si dhe Komisioni nuk ka hetuar mbi aftësinë huadhënëse të babait, xhaxhait, motrës dhe bashkëshortit të saj, lidhur me huat e dhëna subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie.
- 11.2 Lidhur me pasurinë “apartament banimi me sip. 78,4 m², ndodhur në Rrugën e {***}, Tiranë, blerë me kontratën noteriale të shitblerjes me rezervë me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 13.05.2016, me vlerë 75.000 euro”, Komisioneri Publik, nga analizimi tërësor i provave të administruara, bazuar në kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ka vlerësuar se edhe për këtë rast, arsyetimi dhe konkluzionet e Komisionit në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie nuk gjejnë mbështetje ligjore. Referuar gjendjes së akteve dhe vlerës provuese të tyre, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë arritur të justifikojnë bindshëm burimin e krijimit të pasurisë.
- 11.3 Lidhur me mosdeklarimin e pasurisë nga ana e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në bashkëpronësi me familjarët e saj të origjinës, në pjesë takuese të barabarta, e cila është fituar me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, Komisioneri Publik vlerëson se kjo pasuri nuk është

deklaruar as në deklaratat periodike dhe as në deklaratën *vetting*, duke pretenduar se për këto pasuri Komisioni ka zhveshur në mënyrë të gabuar nga bashkëpronësia bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit, pasi ka konkluduar në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm dhe mosdeklarimit të pasurisë, referuar nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

11.4 Komisioneri Publik pretendon se ka pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, për të justifikuar kursimet dhe shpenzimet e deklaruara për vitet 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2016, për të cilat pretendon se rezultojnë me diferencë negative.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegji

a) Juridiksioni i Kolegjit

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimitimi i ankuesit

13. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

14. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 58, datë 01.08.2018, për subjektin e rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve.

B. Mbi aspektet procedurale lidhur me provat dhe kërkesat e Komisionerit Publik dhe atyre të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor, Kolegji konstaton si më poshtë.

15. Komisioneri Publik në parashtrimet e tij që mbajnë datën 03.09.2019, por të depozituara në Kolegji më datë 20.09.2019, pasi u shpreh se u qëndron shkaqeve të ankimit, çmoi të sjellë në vëmendje të Kolegjit dhe kërkoi të vlerësohet si provë, pasi mund t'i shërbejë Kolegjit në vlerësimin tërësor

të çështjes, një informacion të përcjellë më datë 16.11.2018 Komisionerit Publik nga DSIK, të cilin Komisioneri Publik e konsideroi sekret shtetëror.

16. Kolegji pasi ia nënshtroi debatit gjyqësor lejueshmërinë e marrjes si provë të këtij informacioni, me vendim të ndërmjetëm të datës 01.10.2019, konform nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, vendosi lejimin e marrjes si provë të informacionit të përcjellë nga DSIK-ja, dhe për këtë shkak i kërkoi organit kompetent deklasifikimin e këtij informacioni të klasifikuar sekret.
17. Në vijim të kërkesës së Kolegjit, komisioni i deklasifikimit dhe i zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar sekret shtetëror në DSIK, i mbledhur më datë 04.10.2019, mbështetur në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 662, datë 15.12.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror”, si dhe udhëzimin me nr. 99, datë 13.04.2018, “Për zbatimin e rregullores për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror”, me vendimin nr. 255, datë 04.10.2019, ka vendosur të deklasifikojë plotësisht shkresën e përcjellë në Kolegji, konkretisht shkresën me nr. {***}, prot., datë 14.11.2018, për subjektin e rivlerësimit Besnik Muçi me lëndë: “Dërgojmë materiale shtesë për procedurat e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit Besnik Muçi, i nivelit *sekret shtetëror*”.
18. Pas depozitimit në Kolegji, ky dokument që konfirmon deklasifikimin e informacionit në fjalë, i është përcjellë zyrtarisht Komisionerit Publik, subjektit të rivlerësimit dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të cilët në seancën e datës 16.10.2019 konfirmuan se e kanë marrë këtë dokument, i cili, së bashku me aktet shoqëruese të tij, iu nënshtroi debatit gjyqësor dhe u analizua nga Kolegji si më poshtë vijon.
19. Në seancën e datës 20.09.2019, subjekti i rivlerësimit i kërkoi Kolegjit marrjen dhe shqyrtimin në seancë gjyqësore të provave të renditura si më poshtë.

19.1. Vërtetim i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë, nr. {***} prot., datë 06.03.2009, për z. H.M., së bashku me tabelën e shumës së përfutur.

19.2. Certifikatë e regjistrimit në Organin Tatimor Pogradec, datë 10.05.2004, për z. D.M. si person fizik.

19.3. Vendim nr. {***}, datë 10.05.2004, i Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, për regjistrimin e kërkuesit, z. D.M., si person fizik, me aktivitet prodhim dhe shitje buke.

19.4. Kontratë furnizimi me bukë të Komisarariatit të Policisë Pogradec nr. {***}, datë 23.06.2004, nënshkruar midis vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. D.M., si përfaqësues i firmës së prodhimit të bukës dhe ish-Drejtuës të Komisarariatit të Policisë {***}, për periudhën nga 25.06.2004 deri më 31.12.2004.

19.5. Ekstrakt të llogarisë bankare në Raiffeisen Bank Dega Pogradec, nxjerrë në datën 11.02.2019, në emër të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. D.M..

19.6. Vërtetimin e Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut Korçë nr. {***}, datë 31.07.2019, në përgjigje të kërkesës së z. D.M., protokolluar me nr. {***} prot., datë 31.07.2019. Sipas këtij vërtetimi, rezulton se nga këqyrja e dokumentacionit në Arshivën e Komisarariatit të Policisë

Pogradec, subjekti fizik D.M. ka kryer furnizimin e këtij institucioni me produktin bukë gruri, për periudhën qershor 2004 deri në mars 2006, me vlerë 1.501.700 lekë.

19.7. Vërtetim i lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, dega Pogradec, i cili konfirmon faktin se për periudhën tetor 2002 deri në shtator 2005, motra e subjektit, znj. M.M., ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilave është derdhur kontribut. Konkretisht, për këtë periudhë, ka realizuar të ardhura gjithsej 565.000 lekë.

19.8. Vërtetim për të vetëpunësuarit në bujqësi, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, Agjencia Pogradec, lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore të derdhura nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. M. M..

19.9. Vërtetim për të vetëpunësuarit në bujqësi, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, Agjencia Pogradec, lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore të derdhura nga nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. A. M., për periudhën nga viti 1997 – 2008.

19.10. Certifikata familjare e z. M. M. dhe z. D.M..

19.11. Letër e dërguar shtetasit B. C. nga Zyra e të Ardhurave dhe Doganës së Britanisë së Madhe, datë 10.07.2018, në gjuhën angleze.

19.12. Dokument dërguar z. B. C. nga Zyra e të Ardhurave dhe Doganës e Britanisë së Madhe, me nr. reference {***}, datë 13.12.2018, me vulë apostile, i përkthyer dhe i noterizuar.

19.13. Kopje të përkthyer dhe të njësuar me origjinalin të kontratës së qirasë lidhur midis shtetasit B.C. dhe Bashkisë së Maidstone, Britani e Madhe, datë 18.05.2004.

19.14. Certifikatë familjare e z. B. C..

19.15. Kopje të njësuara me origjinalin të pasaportës në emër të motrës së subjektit të rivlerësimit, znj. M. C., ku pasqyrohen pullat e lejeve të qëndrimit në Britaninë e Madhe me nr. {***} dhe {***}.

19.16. Ekstrakt i llogarisë bankare në ProCredit Bank, nxjerrë në datën 11.02.2018, i znj. M.C., në të cilin tregohen edhe veprimet sipas dokumenteve të mësipërme.

19.17. Dokument i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Pensionit të Republikës së Turqisë, datë 06.11.2018, me lëndë: “Dokumenti i regjistrimit të depozitimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore për z. A. M., i legalizuar me vulë apostile të Republikës së Turqisë, përkthyer dhe noterizuar.

19.18. Dokument i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Pensionit të Republikës së Turqisë, datë 06.11.2018, me lëndë “Dokument i regjistrimit të depozitimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore për znj. A. H. M., i legalizuar me vulë apostile të Republikës së Turqisë, përkthyer dhe noterizuar.

19.19. Dokument i lëshuar nga kompania “{***}”, {***}, Turqi, datë 01.03.2019, bordero për z. A. M., i legalizuar me vulë apostile të Republikës së Turqisë, përkthyer dhe noterizuar, dhe dokumenti i lëshuar nga kompania “{***}”, {***}, Turqi, datë 01.03.2019, bordero lëshuar për znj. A. H. M., e legalizuar me vulë apostile të Republikës së Turqisë, përkthyer dhe noterizuar.

19.20. Certifikatë e pronësisë së apartamentit ku ka jetuar vëllai i bashkëshortes së subjektit me bashkëshorten dhe familjen e tij në Turqi, si dhe një deklaratë noteriale e z. E. H., e legalizuar me vulë apostile, përkthyer dhe noterizuar, me të cilën lejon vajzën dhe dhëndrin të jetojnë në apartamentin në pronësi të tij.

19.21. Certifikatë familjare e z. A. M., marrë nga Zyra e Gjendjes Civile e qytetit {***}Turqi, e legalizuar me vulë apostile, e përkthyer dhe e noterizuar.

19.22. Fotokopje të faqeve të para dhe faqeve 67-68 të botimit të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (në vijim “ZQRPP”) “Orientime unifikuese të ZQRPP për rastet dhe praktikatat që kanë të bëjnë me problematika të ndryshme të paraqitura nga ZVRPP¹ për vitin 2014”.

20. Në seancën gjyqësore të datës 01.10.2019, subjekti i rivlerësimit paraqiti edhe këto prova të reja:

20.1. Dokument i printuar i datës 25.07.2019, i Bankës Kombëtare Tregtare, dega Pogradec, që lidhet me llogarinë që i përket z. Z. M..

20.2. Dokument i printuar i datës 25.07.2019, i Bankës Kombëtare Tregtare, dega Korçë, që lidhet me llogarinë që i përket znj. V. S. M..

21. Në seancën gjyqësore të datës 16.10.2019, subjekti i rivlerësimit, në funksion të prapësimeve të shkaqeve të ankimit, paraqiti disa prova, disa prej të cilave të paraqitura gjatë hetimit administrativ në Komision, por jo në formën e kërkuar nga ligji, dhe disa të reja, të cilat listohen si më poshtë.

21.1. Kontratë furnizimi me bukë të Komisarariatit të Policisë Pogradec nr. 4, datë 23.06.2004, nënshkruar midis vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. D. (D.) M.² si përfaqësues i firmës së prodhimit të bukës dhe ish-drejtnesit të Komisarariatit të Policisë Pogradec, z. Kastriot Skenderaj, për periudhën nga 25.06.2004 deri në datën 31.12.2004, në shumën prej 955200 (nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind) lekësh. Furnizimi i komisarariatit ka vazhduar deri në mars të vitit 2006, fakt që provohet edhe me ekstraktin e llogarisë bankare të vëllait në Raiffeisen Bank Dega Pogradec, ku pasqyrohen kreditimet e kësaj llogarie nga Komisaritati i Policisë Pogradec për furnizimin e kryer.

21.2. Një ekstrakt të llogarisë bankare në Raiffeisen Bank, Dega Pogradec, nxjerrë në datën 11.02.2019, në emrin e vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. D.M., në të cilin tregohet një pjesë e shumave të kredituara nga furnizimi me bukë i Komisarariatit të Policisë Pogradec.

21.3. Kopje e noterizuar e librezës së punës së znj. M. C..

21.4. Fashikull për vlerësimin e kriterit profesional, me (100) njëqind fletë, inventarin e të cilit subjekti i rivlerësimit e ka paraqitur me shkrim dore pranë Kolegjit.

22. Në seancën gjyqësore të datës 04.11.2019, subjekti i rivlerësimit paraqiti disa prova, të cilat sipas tij ishin paraqitur edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, por tashmë i kishte sjellë në formën e përkthyer dhe të noterizuar. Këto prova renditen si më poshtë.

¹ Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

² Kontrata e furnizimit me bukë të Komisarariatit të Policisë Pogradec që mban nr. 4, datë 23.06.2004, për firmën “M.”, të nënshkruar rezulton në emër të D. M..

22.1. Kontratë qiraje banese në qytetin {***}, Lavrio, Greqi, datë 01.02.2001 deri më 01.02.2002, me qiradhënës A. G. dhe qiramarrës z. D.M., z. S. M. etj., dorëzuar edhe gjatë hetimit administrativ në Komision.

22.2. Kontratë qiraje banese në qytetin {***}, Lavrio, Greqi, datë 01.03.2002, deri më 01.03.2003, me qiradhënës A. G. dhe qiramarrës z. S. M., z. D.M.etj.

22.3. Kontratë qiraje banese në qytetin {***}, Lavrio, Greqi, datë 01.03.2003 deri më 01.03.2004, me qiradhënës A. G. dhe qiramarrës z. S. M., z. D. M.etj.

22.4. Dokument “Vërtetim lëshimi i numrit të amzës tatimore”, datë 27.02.2001 dhe nr. i deklaratës {***}, lëshuar nga Drejtoria e Shërbimeve Ekonomike, Sektori i Amzës, Lavrio, Greqi, tatimpaguesit z. D.M., ku pasqyrohet fakti se “Vërtetohet se në datën 27.02.2001 u lëshua numri i amzës tatimore: {***}, tatimpaguesit me gjeneralitetet e z. D.M.[...]”, si dhe në paragrafin e fundit theksohet se gjendja tatimore e tatimpaguesit në datën e lëshimit është e rregullt.

22.5. Vërtetim i datës 15.04.1998, lëshuar nga Ministria e Punës, Zyra e Punës në Lavrio, Greqi, i cili vërteton faktin që z. D.M. ka paraqitur kërkesë për leje qëndrimi të kufizuar, ku midis të tjerave ka dorëzuar dhe librezën e shëndetit dhe kontratën e punës. Ky vërtetim ka zëvendësuar lejen e qëndrimit deri në lëshimin e dokumentit.

22.6. Vërtetim i datës 30.05.1998, lëshuar nga Policia e Shtetit, Departamenti për të Huajt në Lavrio, Greqi, për t’u dorëzuar në Zyrën e Punës, i cili vërteton faktin që z. D.M. nuk është i regjistruar në Regjistrin e Shtetasve të Huaj të Padëshiruar, dorëzuar edhe gjatë hetimit administrativ.

22.7. Vërtetim me nr. prot. {***}, datë 19.04.2002, i Spitalit të Përgjithshëm Rajonal Athinë, Greqi, për ekzaminimin dhe konstatimin e faktit që z. D.M. nuk vuan nga ndonjë sëmundje.

22.8. Dokument “Vërtetim i Kartës Jeshile”, datë 26.10.1998, lëshuar nga Ministria e Punës dhe Sigurimit Shoqëror, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Zyra e Punës në Lavrio, Greqi, në të cilin pasqyrohet fakti që z. D.M. ka depozituar gjithë dokumentet për lëshimin e kartës së qëndrimit dhe se ky vërtetim është i vlefshëm deri në lëshimin e Kartës Jeshile. Po ashtu, pasqyrohet fakti që leja e qëndrimit është shtyrë deri në datën 05.04.1999.

22.9. Dokument me titull “Kërkesë/deklaratë e shtetasit të huaj për lëshimin e Kartës me Kohëzgjatje të Kufizuar”, i lëshuar nga Ministria e Punës dhe e Sigurimit Shoqëror, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Greqi, ku pasqyrohet fakti që dokumenti i qëndrimit nr. {***}, datë 10.05.2000, i përket z. D.M. dhe është i vlefshëm deri në datën 19.05.2001.

22.10. Dokument “Kartë qëndrimi me kohë të kufizuar”, lëshuar nga Ministria e Punës dhe e Sigurimit Shoqëror, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Greqi, ku pasqyrohet fakti që leja e qëndrimit për z. D.M. është e vlefshme nga data 10.05.2000 deri në datën 09.05.2001, dorëzuar edhe gjatë hetimit administrativ në Komision.

22.11. Dokument “Vërtetim për rinovimin e Kartës Jeshile”, lëshuar nga Ministria e Punës dhe Sigurimit Shoqëror, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Zyra e Punës në Lavrio, Greqi, datë 03.05.2001, për z. D.M., ku është vendosur dhe vula e vlefshmërisë së Kartës Jeshile deri në datën 30.09.2002.

- 22.12. Vendim nr. {***} prot., datë 19.06.2002, me lëndë “Leje punësimi për shtetasin e huaj”, lëshuar nga qeverisja vendore e Atikës Lindore, Sektori i Punësimit, Pallini, Greqi, ku midis të tjerave pasqyrohet fakti se “[...] pas kërkesës së datës 14.06.2002 të shtetasit të huaj, z. D.M., e cila shoqërohet me dokumentacionin e nevojshëm dhe të cilit i është bashkangjitur karta e qëndrimit me kohëzgjatje të kufizuar nga Zyra e Punës, datë 30.06.2002; i akordojmë shtetasit D.M., i biri i M., shtetas shqiptar, banues në {***}, rruga “{***}”, nr. 10, Leje Pune deri në datën 29.06.2003”.
- 22.13. Dokument i datës 24.02.2003, lëshuar nga Ministria e Punës dhe Sigurimit Shoqëror, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Zyra e Punës në Lavrio, Greqi, me të cilin vërtetohet fakti që z. D.M., mbajtës i Kartës Jeshile me nr. 161330, ka depozituar gjithë dokumentacionin e nevojshëm për rinovimin e saj.
- 22.14. Librezë e mandateve të sigurimit për të punësuarit në vepra teknike dhe ndërtimore, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në të cilën pasqyrohet fakti se z. D.M. është siguruar në kategorinë e “Rëndë”, Dega {***}, Kodi i Degës {***}, nr. amze: {***}. Kjo provë është depozituar vetëm gjatë hetimit administrativ.
- 22.15. Vendim nr. {***}, datë 08.04.2015, i Gjykatës së Apelit Tiranë.
- 22.16. Vërtetim i gjendjes gjyqësore për z. A. L..
- 22.17. Mandatarkëtim i datës 29.12.2017, me përmbajtje derdhje kësti në shumën 4000 (katër mijë) euro në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK.
- 22.18. Mandatarkëtim i datës 26.12.2018, me përmbajtje derdhje kësti në shumë 3000 (tre mijë) euro në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK.
- 22.19. Mandatarkëtim i datës 31.10.2019, me përmbajtje derdhje kësti i fundit i apartamentit në shumën 14000 (katërmëdhjetë mijë) euro në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK.
- 22.20. Kontratë për marrje kredie, datë 30.10.2019, në shumën 2.000.000 (dy milionë) lekë, midis Bankës Kombëtare Tregtare dhe z. Besnik Muçi e znj. E. M..
- 22.21. Kontratë kredie me kufi (*overdraft*) e datës 29.10.2019, në shumën 144.000 (njëqind e dyzet e katër mijë) lekë midis Bankës Raiffeisen dhe znj. E. M..
- 22.22. Bilanci i kompanisë “{***}”, Kasatamonu, Turqi, për vitin 2014.
- 22.23. Bilanci i kompanisë “{***}”, Kastamonu, Turqi, për vitin 2015.
- 22.24. Shkresë me nr. {***} prot., datë 29.10.2019, e ILDKPKI-së në përgjigje të kërkesës së subjektit të rivlerësimit të datës 25.10.2019.
- 22.25. Vendim nr. {***}, datë 10.09.2019, i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
- 22.26. Dokument/letër, datë 28.10.2019, nga znj. M. B. F..
23. Lidhur me provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, të listuara si më sipër, për sa ato lidheshin me shkaqet e ankimit dhe nevojën e subjektit të rivlerësimit për t’i prapësuar ato në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, Kolegji vendosi të lejojë marrjen

dhe nënshtrimin e tyre debatit gjyqësor e më pas i vlerësoi ato në raport me vendimin objekti shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, përveç fashikullit të titulluar nga subjekti i rivlerësimit “Jetëshkrim” (shih paragrafin 21.4) dhe fotokopjeve të faqeve të para dhe faqeve 67-68 të botimit të ZQRPP³ (shih paragrafin 19.22), pasi u konstatua respektivisht, se praktika profesionale në cilësinë e provës nuk lidhej me shkaqet e ankimit dhe, për këtë arsye, nuk ia nënshtrori debatit gjyqësor. Po ashtu, botimet e ZQRPP nuk mund të konsiderohen dhe, për pasojë, të merren si prova në kuptim të ligjit. Në lidhje me dy bilancet e kompanisë “{***}”, Kasatamonu, Turqi, (shih paragrafët 22.22 dhe 22.23), Kolegji, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe kërkesën e tij të përsëritur për dhënien e një kohe shtesë për paraqitjen e provave nga institucionet e Republikës së Turqisë me “apostile”, me vendim të ndërmjetëm të datës 07.11.2019, konform nenit 49, paragrafi 6 i ligjit nr. 84/2016, arsyetoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur të gjithë kohën e nevojshme për t’i sjellë këto akte në formën e kërkuar nga ligji dhe zgjatja e mëtejshme e afateve të gjykimit do të çonte në zvarritjen e tij. Për pasojë, Kolegji e konsideroi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për dhënien e një kohe shtesë për paraqitjen e provave nga institucionet e Republikës së Turqisë me “apostile”, të pabazuar në faktet e pretenduara dhe në ligj dhe, si të tillë, e rrëzoi atë.

24. Kolegji, bazuar në nenin F të Aneksit të Kushtetutës, në pikën 3 të këtij neni dhe në nenet 45 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm të datës 16.10.2019, për nevoja të hetimit të çështjes, konsideroi të nevojshme: *1. T’i kërkojë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë të informojë trupin gjykues nëse në këtë prokurori ka pasur informacione të referuara nga agjencitë ligjzbatuese dhe/ose të trajtuara proceduralisht nga kjo Prokurori për shtetasit A. L., B. O., E. Sh. dhe G. H.. Në rast se përgjigjja për këtë pyetje do të jetë pozitive, i kërkohet kësaj prokurorie të informojë nëse subjekti i rivlerësimit Besnik Muçi është përfshirë në trajtimin e këtyre informacioneve apo i ka trajtuar ato proceduralisht në cilësinë e tij si prokuror dhe zëvendësdrejtues i kësaj prokurorie. 2- T’i kërkojë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë të informojë trupin gjykues nëse në këtë prokurori ka pasur informacione të referuara nga agjencitë ligjzbatuese dhe/ose të trajtuara proceduralisht nga kjo prokurori për shtetasin A. L. për periudhën: viti 2002 deri në vitin 2008. Në rast se përgjigjja për këtë pyetje do të jetë pozitive, i kërkohet kësaj prokurorie të informojë nëse subjekti i rivlerësimit Besnik Muçi është përfshirë në trajtimin e këtyre informacioneve apo i ka trajtuar ato proceduralisht në cilësinë e tij si prokuror pranë kësaj prokurorie.*
25. Në zbatim të kërkesave që Kolegji u ka dërguar dy prokurorive të sipërcituara për informacion, të dyja këto institucione janë përgjigjur duke dërguar informacionet përkatëse. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda është përgjigjur me një informacion të dërguar në datën 28.10.2019, ndërsa Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka kthyer përgjigje zyrtarisht me shkresën e datës 24.10.2019. Nga ana e Kolegjit, këto akte i janë përcjellë paraprakisht Komisionerit Publik dhe subjektit të rivlerësimit dhe i janë nënshtruar gjithashtu debatit gjyqësor në seancën e datës 04.11.2019.

C. Mbi pretendimin e subjektit të rivlerësimit për paraqitjen e ankimit të Komisionerit Publik jashtë afatit ligjor, Kolegji konstaton si më poshtë.

26. Subjekti i rivlerësimit, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegji, pretendoi se ankimi i Komisionerit Publik është jashtë afatit ligjor.

³ Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajjtshme.

26.1. Gjatë parashtrimeve të tij në seancë gjyqësore publike, por edhe në konkluzionet përfundimtare, subjekti i rivlerësimit ngriti pretendimin se ankimi i Komisionerit Publik është paraqitur 90 ditë pas dhënies së vendimit, 45 ditë tej afatit ligjor.

26.2. Në funksion të këtij pretendimi, Kolegji, përveç sa është shprehur në paragrafin nr. 13 të këtij vendimi, çmon të theksojë se me shkresën nr. {***}, datë 17.10.2019, subjektit të rivlerësimit i është njoftuar ankimi i Komisionerëve Publikë, ku sipas lajmërim-marrjes rezultoi se është marrë në dorëzim më datë 17.10.2018, ora 12:23. Në datën 31.10.2018, Komisioneri Publik Darjel Sina ka paraqitur ankim pranë Komisionit, protokolluar me nr. {***}, kundër vendimit nr. 58, datë 01.08.2018, të Komisionit, ditën e katërbëdhjetë nga dita e komunikimit të vendimit, pra brenda afatit ligjor, sipas kërkesave të nenit 63⁴, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Mbi këtë analizë faktike si më sipër, Kolegji e gjen të gabuar pretendimin e subjektit dhe, për pasojë, të pabazuar në ligj.

Ç. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

27. Lidhur me shkakun e ankimit në raport me pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 57 m², me adresë: rruga “{***}”, Tiranë, Kolegji konstaton si më poshtë.
28. Komisioneri Publik, në ankimin e tij për këtë pasuri, pretendoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, duke mos përmbushur detyrimet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, si dhe Komisioni nuk ka hetuar mbi aftësinë huadhënëse të babait, xhaxhait, motrës dhe bashkëshortit të saj, lidhur me huat e dhëna subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie.
29. Faktet e njohura⁵ për Komisionin janë se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* ka deklaruar se ka në pronësi një apartament me sipërfaqe 57 m², me nr. pasurie {***}, volum. {***}, f. {***}, z.k {***}, me adresë: rruga “{***}”, Tiranë. Deklarimin fillestar për këtë pasuri, subjekti e ka bërë në deklaramin e interesave privatë periodikë/vjetorë (në vijim “DIPPV”) të vitit 2006.
30. Origjina e kësaj prone rrjedh nga kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***}. kol., datë 07.01.2006, me vlerë 1900000 lekë, konfirmuar nga korrespondenca me Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (në vijim “ZVRPP”) Tiranë. Gjatë hetimit administrativ në Komision, kjo pasuri e paluajtshme rezultoi të jetë deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPPV-në e vitit 2006. Nisur nga përfundimi që ka arritur Komisioni për ligjshmërinë e të ardhurave në krijimin e shumës së kursimeve në vlerën prej 200.000 lekësh deri në vitin 2006, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe pse analiza financiare e bërë nga Komisioni rezultoi me balancë negative, përfundimi i Komisionit është i gabuar, pasi nuk mbështetet në dokumentet provuese që vërtetojnë deklaramin e subjektit për sa i përket “regjimit të rreptë ushqimor”, detyrim ky i parashikuar në nenin 32 të ligjit nr. 84/2016.
31. Në lidhje me burimin e të ardhurave për pagesën e vlerës së mësipërme, subjekti fillimisht ka deklaruar tre zëra të ardhurash:

⁴ Neni 63, “Paraqitja e ankimit”: 1. Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelineve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit [...].

⁵ Neni 49, paragrafi 3 i ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Faktet e njohura për Komisionin ose faktet e njohura botërisht, si dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme”.

- i) hua nga babai, z. M. M., në vlerën 500.000 lekë;
- ii) hua nga xhaxhai, z. H.M., në vlerën 3.000 euro; dhe
- iii) hua nga motra, M. C., dhe bashkëshorti i saj, B. C., në vlerën 6000 euro.

Në deklaratën *vetting*, të dorëzuar më datë 30.01.2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi katër zëra të ardhurash si burim krijimi, duke shtuar edhe kursimet e tij:

- (i) kursime personale në shumën 200.000 lekë;
- (ii) hua 500.000 lekë nga babai, që vijnë nga të ardhura personale dhe kursime të vëllait, D.M., nga emigracioni;
- (iii) hua 6000 euro nga motra M. C. dhe bashkëshorti i saj B. C., që vijnë si të ardhura nga emigracioni në Angli;
- (iv) hua 3.000 euro nga xhaxhai, H.M., krijuar me të ardhura nga emigracioni.

32. Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e kësaj pasurie gjatë procesit të rivlerësimit, në verifikim të këtyre deklaratimeve në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme, ka konstatuar se në datë 27.3.2006, nëpërmjet dorëzimit të DIPPV-së së vitit 2005, subjekti ka deklaruar interesat e tij privatë, bazuar në ligjin nr. 9049/2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), por nuk ka deklaruar kursimet në shumën 200.000 lekë.
33. Në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni pasi ka administruar si provë DIPPV-në e vitit 2005, i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* për herë të parë se ka zotëruar si kursime një shumë prej 200.000 lekësh, të mbajtura *cash* në shtëpi në vitin 2005. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga paga e tij për vitin 2005, në shumën 805.398 lekë, si dhe shpenzime qiraje në shumën 200.000 lekë.
34. Gjatë hetimit administrativ në Komision, nga analiza financiare për vitin 2005, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me një balancë financiare negative në vlerën -199.945 lekë. Lidhur me këtë fakt, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit.
35. Lidhur me këtë shkak të ankimit të Komisionerit Publik si në paragrafin nr. 30 më sipër, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në shpjegimet e tij se familja e tij gjatë këtyre viteve ka ndjekur një “regjim të rreptë kursimi”, fëmijët kanë qenë të vegjël, familja e tij ka përdorur shërbimin publik për transport, nuk ka udhëtuar jashtë Republikës së Shqipërisë, familja e tij është ndihmuar me shuma monetare dhe në forma të ndryshme nga familja e origjinës në fshat dhe ka marrë produktet bujqësore e blegtorale nga fshati etj.
36. Pas dëgjimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka arritur në përfundimin se: *Në lidhje me balancën financiare negative, duke marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nga subjekti për ndjekjen e një “regjimi të rreptë kursimi”, si dhe ndihmat materiale të dhëna gjatë kësaj periudhe nga familjaret e tij, ajo rezulton të jetë e papërfillshme dhe nuk mund të arrihet në konkluzionin që kemi të bëjmë me shkelje ligjore, që mund të çojnë deri në shkarkimin e subjektit nga detyra.*
37. Në përfundim të hetimit, Komisioni ka justifikuar ligjshmërinë e shumës së kursimit nga subjekti në vlerën 200.000 lekë, edhe pse nga analiza financiare për vitin 2005, e bërë nga vetë Komisioni, rezulton me një balancë negative.
38. Në analizë të sa më sipër, Kolegji vlerëson se subjekti nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e pasurive dhe të të ardhurave, detyrim i cili rrjedh nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, sipas

të cilës subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Justifikimi i kursimeve të subjektit për mbajtjen e një “regjimi të rreptë kursimi” nga familja e tij dhe mundësia e krijimit të kursimeve në vlerën prej 200.000 lekësh deri në fund të vitit 2005, nuk u provua nga subjekti, ndaj mbetet në nivel deklarativ, kjo bazuar edhe në analizën financiare të këtij viti, nga e cila diferenca të ardhura minus shpenzime është negative. Ky konkluzion i Komisionit është i pambështetur në prova dhe në dispozitat e ligjit nr. 84/2016 dhe, si i tillë, shkaku i ankimit të Komisionerit Publik është i drejtë.

39. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, të paraqitur për herë të parë në Kolegj, për t’iu referuar shpenzimeve të jetesës sipas shkresës së ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 29.10.2019 (shih paragrafin 22.24), Kolegji vlerëson se situata financiare për këtë skenar, nëse për shpenzime jetese do të konsideronim shpenzimet e jetesës sipas kësaj shkrese dhe gjithashtu duke marrë në konsideratë edhe mundësinë për kursim në banesë në fund të vitit 2005 në vlerën 161815,67, diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve do të ishte -80926,59 lekë, pra përsëri situata financiare negative e subjektit të rivlerësimit nuk do të ndryshonte, pra ai përsëri nuk kishte mundësi për të krijuar kursime në shumën 200.000 lekë.
40. Në lidhje me huan e marrë nga z. M. M., rezulton se në deklaratën *vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka marrë hua nga babai i tij, për blerjen e apartamentit në rrugën “{***}”, ashtu si dhe në DIPPV-në e vitit 2006, si një nga zërat e të ardhurave të deklaruara për blerjen e sendit, në vlerën prej 500.000 lekësh. Sipas deklarimeve, të ardhurat e huas janë siguruar nga puna në bujqësi dhe puna në emigracion, Greqi. Kjo marrëdhënie huaje është formalizuar me shkrim dore në një shkresë të thjeshtë pa datë, e titulluar “Deklaratë”. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit paraqiti edhe një vërtetim të Njësisë Administrative {***}, Bashkia Pogradec, nr. {***} prot., datë 08.06.2018, nga ku rezulton se z. M. M. ka në zotërim tokë bujqësore, duke realizuar nga kjo e fundit të ardhura vjetore në shumën 64.630 lekë. Deklarata pa datë, me shkrim dore e huadhënësit, z. M. M., konfirmon huan e dhënë, dhe si burim krijimi për këtë hua deklaroi kursimet personale dhe të ardhurat nga emigracioni i djalit tjetër, D.M.. Lidhur me të ardhurat nga emigracioni i të vëllait, shtetasit D.M., subjekti ka paraqitur deklaratë pa datë, me shkrim dore, të vëllait, ku deklaroi se ka qenë emigrant dhe realizonte të ardhura mesatare mujore 1.500 - 2.000 euro/muaj.
41. Në deklaratën *vetting*, subjekti deklaroi se për blerjen e apartamentit në rr. “{***}” ka marrë hua nga xhaxhai i tij, z. H.M., në vlerën prej 3.000 euro. Sipas deklarimeve, të ardhurat e huas janë siguruar nga puna në bujqësi dhe kursime nga emigracioni në Greqi. Për të provuar aftësinë huadhënëse të xhaxhait të tij, subjekti i ka paraqitur Komisionit si provë shkresore vërtetimin nr. {***} prot., datë 08.06.2018, nga Njësia Administrative {***}, Bashkia Pogradec, ku rezulton se z. H.M. ka në zotërim tokë bujqësore dhe realizon prej saj të ardhura vjetore në shumën 111.465 lekë.
42. Komisioneri Publik, në ankimin e tij, për këto hua si më sipër shprehet se: *Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të provuar aftësinë huadhënëse të babait dhe xhaxhait, Komisioni nuk ka hetuar mbi vlefshmërinë ligjore dhe provueshmërinë e tyre, por i ka marrë të mirëqena ato. Vlerësojmë se disa prej tyre nuk kanë asnjë vlerë provuese në formën e paraqitur, sepse janë vetëdeklarime dhe të tjera, dokumente pa vulë apostile, me përkthim të thjeshtë nga gjuha greke, pa u vërtetuar nënshkrimi i përkthyesit nga noteri publik. Pra, në kushtet kur një akt shkresor është mbajtur dhe lëshuar në territorin e një shteti tjetër si dhe në gjuhë të huaj, duhet të respektohen elementet formale për vlefshmërinë e tij, të përcaktuara*

në parashikimet e Konventës së Hagës, datë 5 tetor 1961, apo parashikimet e nenit 266 të K.Pr.Civile, i cili kërkon se: “Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhën shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent”.

*Gjithashtu, konkluzioni i Komisionit është i pabazuar, pasi ai nuk mbështetet në asnjë analizë financiare. Nga arsyetimi i vendimit nuk na rezulton që Komisioni të ketë hetuar dhe kryer analizë të detajuar, nëse familja e huadhënësit M. M. dhe H.M. ka realizuar apo jo të ardhura të tjera, përveç sa konfirmuar nga Njësia Administrative {***}, numrin e personave të përbërjes familjare, si dhe të shpenzimeve të kryera nga i ati për ndërtimin e banesës së tij në tokën e fituar, me qëllim përlllogaritjen e mundësisë së tij për të dhënë këtë hua.*

Komisioni, në referencë të standardit të vendosur prej tij në raste të ngjashme (shih vendimin e KPK-së nr. 12, datë 23.3.2018), ka pasur korrespondencë dhe ka administruar në cilësinë e provës të dhëna nga organet tatimore përkatëse për vërtetimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave të pretenduara si burim krijimi pasurie nga subjektet e rivlerësimit, duhet të kishte shteruar hetimin në këtë drejtim dhe pas administrimit të dokumentacionit tatimor të kualifikonte si të ligjshme të dyja huat e deklaruar si zë të ardhurash për krijimin e pasurisë.

43. Kolegji, pasi dëgjoji Komisionerin Publik dhe subjektin e rivlerësimit, mori dhe shqyrtoi provat e reja të paraqitura për këtë shkak ankimi dhe ia nënshtroi ato debatit gjyqësor, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme të të ardhurave për të kursyer në fund të vitit 2005 dhe nuk arriti të justifikojë ligjshmërinë e burimeve të huave, të deklaruar të marra nga babai dhe xhaxhai. Kjo pasi edhe me provat e reja të shqyrtuara në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm mundësitë financiare të babait dhe xhaxhait të tij për t'i dhënë huat e pretenduara.
44. Në dokumentet e sjella nga subjekti në seancat gjyqësore në Kolegj, nuk rezultoi i provuar burimi i krijimit të kursimeve të xhaxhait të subjektit të rivlerësimit, si të ardhura nga emigracioni, pasi dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit jep informacione vetëm për të ardhurat e përfituara nga pensioni i pleqërisë. Në vërtetimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore të Drejtorisë Rajonale Korçë, specifikohet se z. H.M. që prej vitit 1991 deri në vitin 2006 ka përfitur të ardhura në vlerën 1.325.629 lekë. Të ardhurat e përfituara nga pensioni i pleqërisë për vitin 2005 (një vit para se të jepej huaja) janë në vlerën 159.910 lekë, duke mos qenë as në këtë mënyrë të mjaftueshme për plotësimin e vlerës së dhënë hua.
45. Në dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se prindërit e subjektit kishin vetëm tokën bujqësore si burim të ardhurash dhe prej përfitimit të këtyre të ardhurave ata kanë derdhur kontributet vullnetare për efekt të përfitimit të vjetërsisë për pension pleqërie. Nëse do të ndiqnim logjikën e pretenduar nga subjekti për të përlllogaritur të ardhurat për kontributet e paguara, do të rezultonte se vlera e këtyre të ardhurave do të ishte me e lartë se të ardhurat e siguruar nga toka bujqësore, të përcaktuara në shkresën nga Njësia Administrative {***}. Në dokumentet e sjella nga subjekti në Kolegj, nuk rezultoi i provuar burimi i krijimit të kursimeve të babait të tij, të deklaruar si të ardhura nga emigracioni.
46. Kolegji shqyrtoi për këtë shkak ankimi të gjithë dokumentacionin e administruar në fashikullin e Komisionit dhe atë të depozituar gjatë gjykimit në Kolegj, konkretisht: vendimin e Gjykatës të Shkallës të Parë Pogradec për regjistrimin si person fizik privat të z. D.M., për ushtrimin e veprimtarisë private në aktivitetin prodhim e shitje buke; kontratën e lidhur midis Komisarimit të Policisë Pogradec dhe firmës “{***}” ShPK, e përfaqësuar nga z. D.M., për furnizimin me bukë

të Komisarariatit të Policisë për periudhën 23.06.2004 - 31.12.2004, për vlerën 955.200 lekë; balancën e llogarisë bankare të z. D.M.si person fizik në Raiffeisen Bank, në të cilën gjenden lëvizjet e llogarive bankare të tij dhe pagesat e kryera nga Komisarati i Policisë Pogradec për furnizimin me bukë nga ana e firmës “{***}” ShPK.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se llogaria bankare e z. D. M. në vitin 2005 është kredituar nga Komisarati i Policisë Pogradec në shumën 711.350 lekë. Nga informacioni që japin provat e reja nuk specifikohet sa janë të ardhurat e gjeneruara nga ky aktivitet tregtar. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit në prapësimet dhe pretendimet e tij gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore nuk arriti të shpjegojë⁶ bindshëm burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave nga aktiviteti tregtar i vëllait të tij.

Nga kreditimi i llogarisë dhe nga kontrata e nënshkruar midis Komisarariatit të Policisë Pogradec dhe z. D.M. mund të kuptohet se aktiviteti tregtar është ushtruar, por nuk arrihet të provohet aftësia e kursimit të tij, duke qenë se vlera e kontratës është vlerë shitjeje, por jo fitim pas pagesës së tatimit.

Subjekti i rivlerësimit, edhe pse mbajti të njëjtin qëndrim si në Komision dhe paraqiti edhe prova të reja në Kolegj, përsëri nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e deklaruar të kursimit nga z. M. M., se cilat kanë qenë mundësitë e kursimet nga emigracioni dhe puna në bujqësi.

47. Për sa i përket dokumentacionit të sjellë nga subjekti i rivlerësimit për verifikimin e jetesës dhe punës së vëllait të tij në territorin e Republikës të Greqisë, nuk u gjet asnjë dokument nga institucionet zyrtare të Greqisë që të provonin se sa ishin të ardhurat e përfituara nga vëllai i subjektit gjatë jetesës në këtë shtet. Këto dokumente nuk tregojnë për të ardhurat e siguruara nga ky i fundit, por provojnë vetëm jetesën e tij në Greqi.
48. Kolegji e gjeti të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik në lidhje me aftësitë huadhënëse të babait dhe xhaxhait të subjektit të rivlerësimit, respektivisht në vlerën 500.000 lekë dhe në vlerën 3.000 euro, pasi edhe pse subjekti i rivlerësimit ka pasur rreth një vit kohë që nga momenti që është vënë në dijeni të ankimit të Komisionerit Publik, nuk arriti të provojë bindshëm mundësitë financiare të personave të tjerë të lidhur të tij për t'i dhënë huat e deklaruar si burim për krijimin e pasurisë së sipërcituar.
49. Në lidhje me huan e marrë nga personi tjetër i lidhur, motra M. C. dhe bashkëshorti i saj B. C., Komisioneri Publik ka pretenduar se subjekti, në DIPPV-në e dorëzuar për vitin 2006 dhe në deklaratën *vetting*, si një nga zërat e të ardhurave të deklaruar për blerjen e sendit është dhe huaja e marrë prej këtij personi tjetër të lidhur, në vlerën prej 6.000 eurosh. Huaja është formalizuar në një akt të shkruar me shkrim dore. Si provë për aftësinë financiare të personit tjetër të lidhur për të dhënë hua, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentet: i) deklaratë me shkrim dore të motrës dhe kunatit, pa datë, në të cilën deklarohet se në vitet 1997 - 2009 kanë qenë emigrantë në Mbretërinë e Bashkuar; ii) numrat e sigurimit të lëshuar nga autoritetet zyrtare të Britanisë së Madhe/Mbretërisë së Bashkuar, ku vërtetohen disa kreditime/pagesa në favor të kunatit B. C.; iii) korrespondencën *online* të znj. M. C. me Bankën HSBC në Mbretërinë e Bashkuar, ku rezulton se janë kërkuar informacione mbi llogaritë bankare.

⁶ Në nenin D, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës parashikohet: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”.

50. Komisioneri Publik në lidhje me këtë hua, në ankim ka pretenduar se: *Për sa i përket dokumentacionit justifikues, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të provuar aftësinë huadhënëse të motrës M. C. dhe kunatit B. C., Komisioni nuk ka hetuar mbi vlefshmërinë ligjore dhe provueshmërinë e tyre, por i ka marrë të mirëqena ato. Vlerësojmë se gjithë provat e paraqitura faktojnë deklarinimin e personave të lidhur mbi jetesën dhe mundësinë e punësimit në Angli, por asnjë prej tyre nuk provon të ardhurat e realizuara nga punësimi. Dokumentet e mësipërme janë fotokopje të thjeshta, disa vetëm në gjuhën angleze. Nga ana formale, këto dokumente nuk kanë fuqi provuese, sepse janë kopje, pa vulë apostile, disa pa përkthim dhe të tjerat me përkthim të thjeshtë, u mungon vërtetimi i nënshkrimit të përkthimit nga noteri publik. Komisioni, edhe pse ka administruar me cilësinë e provës dokumentacionin bankar të personit të lidhur, nuk ka verifikuar përmbajtjen e tij. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare të znj. M. C. në ProCredit Bank, rezulton se vetë subjekti në dy raste ka derdhur shuma në llogarinë në euro të motrës M. C. në ProCredit Bank. Konkretisht, në vitet 2005 - 2006 janë kryer disa derdhje në llogari, me përshkrimin: pagesë për studime, nga të cilat, në korrik 2006, depozituar 5.000 euro nga Besnik Muçi, në shtator 2006, depozituar 6.000 euro nga Besnik Muçi dhe në tetor 2007, tërhequr 5.000 euro nga Besnik Muçi, me prokurë. Shumat e derdhura për studime duket që janë transferuar/tërhequr me pjesë. Komisioni nuk ka pyetur subjektin për shumat me të cilat ka kredituar llogaritë e motrës së tij, ndërkohë që kjo e fundit i ka dhënë huan në shumën 6.000 euro, fakt i cili në optikën e Komisionerit Publik do të duhej të hetohej në mënyrë shteruese. Në çdo rast, aktet e administruara në dosje nuk provojnë mundësinë huadhënëse të personit tjetër të lidhur, znj. M. C. dhe z. B. C. në vitin 2006. Gjithashtu, konkluzioni i Komisionit është i pabazuar, pasi ai nuk mbështetet në asnjë analizë financiare. Komisioni për sa ka arsyetuar në vendim, nuk na rezulton që të ketë kryer analizë financiare dhe të ketë hetuar nëse familja e huadhënësit M. C. dhe B.C. ka realizuar apo jo të ardhura të ligjshme, numrin e personave të përbërjes familjare, si dhe shpenzime të kryera nga ata për jetesë apo dhe të tjera në periudhën e emigrimit, nëse kanë investuar në pasuri, me qëllim për llogaritjen e mundësisë së tyre për të dhënë këtë hua. Në zbatim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pika 4, nenit 30 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni duhet të dilte në përfundimet përkatëse për ligjshmërinë e të ardhurave të personit tjetër të lidhur, vetëm pasi të krijonte bindjen se ato (të ardhurat) ekzistojnë në momentin e dhënies së huas dhe se ekzistenca e tyre justifikohet nga burime të ligjshme. Ndryshe nga përfundimet e arritura nga Komisioni, të cilat janë pasqyruar në pjesën arsyetuese të vendimit nr. 58, datë 1.8.2018, në vlerësimin e Komisionerit Publik, në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave që janë deklaruar se kanë shërbyer për blerjen e pasurisë së paluajtshme "Apartament banimi me sipërfaqe 57 m², me adresë rr. "{***}"", na rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, ka kryer deklarinim të pamjaftueshëm, në referencë të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
51. Në lidhje me këtë huadhënie në vlerën 6000 euro, Komisioni ka arritur në konkluzionin se nuk ka dyshime në lidhje me aftësinë huadhënëse të motrës dhe kunatit të subjektit të rivlerësimit.
52. Sipas Komisionerit Publik, përfundimi i Komisionit nuk është i bazuar në gjendjen faktike të provave dhe në dispozitat e ligjit nr. 84/2016. Huaja nuk mund të konsiderohet si burimi i ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie për argumentet si vijojnë. Për sa i përket dokumentacionit justifikues, paraqitur nga subjekti për të provuar aftësinë huadhënëse të personave të sipërpërmendur,

Komisioni nuk ka hetuar mbi vlefshmërinë ligjore dhe provueshmërinë e tyre, por i ka marrë të mirëqena ato.

53. Komisioneri Publik vlerëson se këto dokumente nuk provojnë të ardhura të realizuara nga punësimi. Për më tepër, këto dokumente nuk janë paraqitur në formën e kërkuar nga ligji, janë fotokopje, pa vule apostile, disa të papërkthyer, të panoterizuara etj. Nuk ka dokumentacion financiar për mundësinë financiare të kumatit dhe motrës së subjektit.
54. Subjekti i rivlerësimit nga ana e tij është mbrojtur duke deklaruar në pretendimet përfundimtare: *Lidhur me huan prej 6000 eurosh nga motra dhe bashkëshorti i saj, pas parashtrimeve dhe provave të dorëzuara në seancën e datës 20.09.2019, Komisioneri Publik në seancën e datës 01.10.2019 ka vlerësuar se kjo shumë mbulohet me burime të ligjshme të personave të tjerë të lidhur, referuar nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 [...].*
Sikurse kam shpjeguar, ritheksoj që këto shuma më janë dhënë nga familjarët e shtetasit B.C. dhe se, sipas dokumenteve të ardhura nga autoritetet britanike, gjatë kësaj periudhe bashkëshorti i motrës B.C. ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të financuar kryerjen e këtyre transaksioneve. Konkretisht, për vitin 2006 të ardhura neto 18.979 paund dhe për vitin 2007 të ardhura neto 19.115 paund [...].
Këto shuma monetare janë sjellë në Shqipëri nga vetë shtetasi B. C., i cili në atë periudhë ka ardhur në Shqipëri, dhe të njohur të tij. Më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj që në shtator të vitit 2005 motra ime ka pasur në llogarinë e saj në Shqipëri një shumë prej 8.400 eurosh, shumë e cila është administruar nga familjarët e bashkëshortit të saj pas muajit tetor 2015, kur ajo është larguar për në Britaninë e Madhe [...].
*Po ashtu, Komisioneri i referohet Udhëzimit të ILDKPKI-së nr. {***}, datë 10.10.2016, i cili nuk mund të zbatohet në këtë rast me fuqi prapavepruese, pasi veprimet e analizuara janë kryer në vitet 2005-2007 dhe akti normativ ka dalë 10 vjet më vonë.*
55. Kolegji vlerëson se bazuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioni, në lidhje me këtë huadhënie, vërehet se problematikat e ngritura në ankim nga Komisioneri Publik janë të dukshme. Këto problematika, në formën e gabimeve procedurale të kryera nga ana e Komisionit, u korrigjuan me dokumentacionin që ka paraqitur subjekti i rivlerësimit në Kolegj, i cili u soll në formën e kërkuar nga ligji, pasi në Komision dokumentacioni ishte administruar në formën e akteve fotokopje të panoterizuara dhe të papërkthyer në disa raste, mungonte vula apostile. Gjithashtu, u konstatua se Komisioni nuk ka hetuar mbi mundësitë financiare të personave të tjerë të lidhur, të ardhurat e tyre të ligjshme nga punësimi, si dhe pagesa e tatimit mbi to. Mungonte analiza financiare dhe nuk provohen të ardhurat e ligjshme të personave të tjerë të lidhur, që janë motra, znj. M. C., dhe kunati, z. B. C.. Gjithashtu, Komisioni nuk kishte hetuar edhe në lidhje me lëvizjet monetare që ka bërë subjekti i rivlerësimit në një llogari bankare në emër të motrës së tij, e cila përdorej nga subjekti i rivlerësimit me prokurë nr. {***} regj., datë 04.10.2007, e hartuar dhe nënshkruar para të ngarkuarit për veprime konsullore pranë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, z. D. K. dhe në periudha të ndryshme subjekti i rivlerësimit kreditonte dhe tërhiqte vlera monetare nga kjo llogari.
56. Kolegji në jurisprudencën e tij, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 30 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ka mbajtur dhe mban qëndrimin se subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllime të këtij ligji, sipas dispozitave të mësipërme, konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Në lidhje me këtë huadhënie, nuk janë bërë

hetime shteruese nga ana e Komisionit. Komisioni duhet të dilte në përfundimet shteruese për ligjshmërinë e të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, vetëm pasi të krijonte bindjen se të ardhurat ekzistojnë në momentin e dhënies së huas dhe se ekzistenca e tyre justifikohet nga burime të ligjshme.

57. Kolegji, pasi mori rregullisht dhe shqyrtoi edhe provat e reja të sjella nga subjekti i rivlerësimit për këtë shkak ankimi, vëren se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit Besnik Muçi për këtë rast përbëhet nga një material prej 123 faqesh me dokumente nga institucione⁷ të ndryshme të Mbretërisë së Bashkuar, të renditura në këtë vendim në paragrafët nga nr. 19.11 deri në nr. 19.16, me të cilat pretendohet të provohen të ardhurat dhe shpenzimet respektivisht nga punësimi dhe jetesa në këtë shtet të huadhënësve, znj. M. dhe z. B. C..
58. Dokumentacioni përfshin një shkresë nga institucionet shtetërore të të dhënave në Mbretërinë e Bashkuar, më të cilën specifikohet se z. B.C. është regjistruar me nr. sigurimesh kombëtare në datën 13.08.1997. Në këtë dokument gjenden edhe adresat në të cilat ka banuar z. B.C. gjatë periudhës së jetesës në Mbretërinë e Bashkuar. Në dokumentacion specifikohet gjithashtu se z. B.C. ka marrë ndihmë për një fëmijë nën moshën 6 vjeç, nga data 03.07.2008 deri në datën 02.07.2020.
- Gjatë periudhës 2004-2005, kunati i subjektit të rivlerësimit ka punuar në Mbretërinë e Bashkuar pranë kompanisë {***}. Në vitin 2004, z. B.C. ka përfituar të ardhura nga punësimi në vlerën 850.702,91 lekë⁸. Rezulton se shpenzimet e jetesës për një person të vetëm, sipas faqes të statistikave Eurostat⁹, janë në vlerën 1.419.697,3 lekë. Nga diferenca ardhura shpenzime, rezulton se z. B.C. nga punësimi në Mbretërinë e Bashkuar nuk mund të mbulonte shpenzimet e tij në vlerën -568.994,39 lekë.
- Në vitin 2005 z. B.C. ka përfituar të ardhura nga puna e tij në Mbretërinë e Bashkuar në vlerën 2.414.748,02 lekë¹⁰; shpenzimet e jetesës llogaritur sipas faqes së statistikave Eurostat për vitin 2005 janë në vlerën 1.381.131,45 lekë. Në këtë vit, në llogarinë bankare të ProCredit Bank në emër të bashkëshortes së z. B. C., znj. M. C., janë kryer kreditime në vlerën 13.720 euro, kundërvlehtë e të cilave do të ishte 1.681.797,60 lekë, sipas kursit historik të Bankës të Shqipërisë¹¹, të cilat sipas konkluzioneve përfundimtare të subjektit të rivlerësimit në datën 12.11.2019, gjatë seancës gjyqësore, janë sjellë në Shqipëri nga vetë shtetasi B. C.. Nga diferenca e të ardhurave me shpenzimet rezulton se z. B.C. ka pasur mundësi të kursejë vlerën 1.033.616,56 lekë, e cila rezulton e pamjaftueshme për të kredituar llogarinë e bashkëshortes së tij në ProCredit Bank në shumën prej 13.720 eurosh, për të përballuar shpenzimet e jetesës dhe gjithashtu për të pasur aftësi huadhënëse ndaj subjektit të rivlerësimit.
59. Lidhur me shkakun e ankimit në raport me pasurinë apartament me sipërfaqe 78,4 m², ndodhur në Tiranë, Rruga e {***}, Kolegji konstaton si më poshtë.

⁷ Her {***} and {***}.

⁸ Kundërvlehtë e 4600,9 GBP, të konvertuara në lekë me kursin mesatar të vitit 2004 dhe 2005, të publikuar nga Banka e Shqipërisë.

⁹ <https://ec.europa.eu/eurostat>

¹⁰ Kundërvlehtë e 13.059,81 GBP, të konvertuara në lekë me kursin mesatar të viteve 2004 dhe 2005, të publikuar nga Banka e Shqipërisë.

¹¹ https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/

60. Komisioneri Publik, për këtë pasuri, të blerë nga subjekti i rivlerësimit për shumën 75.000 euro, me kontratën nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 13.5.2016, si burim krijimi janë deklaruar: (i) kursime nga të ardhurat prej punës së subjektit dhe bashkëshortes 25.000 euro; (ii) hua në shumën 15.000 euro nga A. M. dhe A. H. (i vëllai i bashkëshortes së subjektit me bashkëshorten e tij, shtetase turke), burimi është nga kursimet e tyre prej punës në kompaninë “{***}”, në pronësi të babait të A. H. dhe menaxhimi i dy dyqaneve, shitje me shumicë dhe pakicë, mobileri me sip. 2.000 m² dhe 3.600 m², ndodhur në qytetin Kostamonu, Turqi. Shuma prej 15.000 eurosh është transferuar nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare (në vijim “BKT”) në datën 16.05.2016; (iii) kredi bankare pranë BKT-së, datë 05.12.2016, në shumën 1.500.000 lekë, ankon vetëm faktin në lidhje me huan e marrë nga z. A. M. dhe znj. A. H., duke u shprehur në ankim se: *Ndryshe nga përfundimi i Komisionit se: “duke marrë në konsideratë analizën e llogarive bankare, deklarimet e subjektit [...] nuk ka dyshime në lidhje me ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave monetare”, Komisioneri Publik çmon se aktet e administruara nuk të krijojnë bindjen se të ardhurat e deklaruar si hua justifikojnë burimin e ligjshëm të tyre, pasi dokumentacioni i paraqitur nga subjekti prej Institutit të Sigurimeve Shoqërore Turke merret me rezervë për vlerën provuese të tij. Në aspektin formal, ky dokumentacion nuk shoqërohet me vulën apostile, si dhe nuk vërteton se sa janë të ardhurat e realizuara nga personat e lidhur për periudhën 2012 - 2016. Edhe në këtë rast rezulton se Komisioni nuk ka hetuar apo të ketë kryer analizë financiare mbi të ardhurat e realizuara nga huadhënësit, kostot e jetesës së tyre dhe mundësinë e këtyre personave për të dhënë hua shumën prej 15.000 eurosh. Si rrjedhim, për sa kohë që subjekti dhe personat e lidhur nuk provojnë bindshëm ligjshmërinë e kësaj huaje, në kuptim të nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në pamundësi financiare për mbulimin me të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë së mësipërme (për pjesën e deklaruar të mbuluar nga huaja).*
61. Nga aktet e administruara në dosje rezulton se, më datë 13.5.2016, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e blerësit, dhe shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK, me administrator dhe ortak të vetëm z. A. L. në cilësinë e shitësit, kanë lidhur një kontratë shitblerjeje me rezervë, me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., me objekt shitjen e apartamentit me sip. 78,4 m², për çmimin 75.000 euro. Sipas kontratës, pagesa e çmimit të apartamentit do të kryhej në dy këste, kësti i parë, në shumën 40.000 euro, është shlyer, konfirmuar nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit pranë BKT-së. Subjekti ka depozituar shumën prej 10.000 euro më datë 22.7.2014 dhe 15.000 euro më datë 16.5.2016. Më datë 12.5.2016 rezulton e kredituar nëpërmjet transfertës bankare shuma prej 14.951,83 eurosh. Shuma e akumuluar prej 40.000 eurosh është transferuar në llogarinë bankare të noterit, me përshkrimin “tjetërsim pasurie sipas kontratës për blerje pasurie nr. {***} rep., {***} kol., datë 13.5.2016”. Ndërsa këstin e dytë prej 35.000 eurosh, palët kontraktore kanë rënë dakord që të shlyhet nëpërmjet llogarisë bankare të noterit deri në maj të vitit 2019. Në ZVRPP, kjo pasuri është e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe është e bllokuar në favor të shitësit, deri në likuidimin e plotë të shumës, çmimit të shitjes.
62. Komisioneri Publik, nga analizimi tërësor i provave të administruara, bazuar në kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pretendon se edhe në këtë rast, arsyetimi dhe konkluzionet e Komisionit në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, nuk gjejnë mbështetje ligjore. Referuar gjendjes së akteve dhe vlerës provuese të tyre, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë arritur të justifikojnë bindshëm burimin e krijimit të pasurisë. Komisioni, në mënyrë të gabuar, ka mbajtur qëndrimin në lidhje me huan prej 15.000 eurosh nga personat e lidhur se: *shuma është transferuar nëpërmjet*

BKT-së., çka do të thotë se kemi të bëjmë me një transfertë nga banka në bankë, duke legjitimuar kështu burimin e të ardhurave që justifikon këtë gjendje financiare në bankën e origjinës prej nga është bërë transfertja.

63. Komisioneri Publik pretendon se pasja ose jo e likuiditeteve në llogari bankare apo transfertë bankare nuk janë fakte që legjitimojnë burimin e të ardhurave. Vlerësimi mbi legjitimitimin e burimit të pasurisë del si rezultat i hetimit administrativ të Komisionit dhe bëhet vetëm nëse plotësohen kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
64. Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion një mandat të Bankës Credins, ku verifikohet derdhja e shumës prej 14.000 eurosh, datë 06.12.2016, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, me përshkrim veprimi: *derdh B. M., shlyerje detyrimi për banesë, kredi të BKT-së, të ardhurat personale*, çfarë përputhet me deklarinë e subjektit në deklaratën *vetting* dhe në pyetësorët e Komisionit mbi përdorimin e kredisë së marrë, dhe një pjesë të kursimeve personale për likuidimin e këstit prej 14.000 eurosh.
65. Në lidhje me huan në shumën 15.000 eurosh nga z. A. M. dhe znj. A. H., respektivisht i vëllai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten e tij, në Kolegj rezultoi se shuma prej 14.951,83 eurosh është transferuar në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit Besnik Muçi pranë BKT-së në datë 16.5.2016, dhe për mundësinë e personave të tjerë lidhur për kursimin e shumës dhe ligjshmërinë e saj, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës dokumentacion nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Republika e Turqisë, për individët znj. A. H. dhe z. A. M.. Ky dokumentacion është i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar, dhe tregon se shtetasit e mësipërm kanë paguar sigurime shoqërore në përputhje me legjislacionin në fuqi për periudhën 2012 – 2017, ndërsa znj. A. H. edhe për vitin 2006 (1 muaj) dhe për vitin 2007 (2 muaj).
66. Komisioneri Publik, si shkak në ankim për pasurinë e mësipërcituar ka huan e marrë shtetasit A. H. dhe A. M., duke pretenduar fillimisht në ankim se aktet e administruara në Komision nuk të krijojnë bindjen se të ardhurat e deklaruara si hua justifikojnë burimin e ligjshëm të tyre, pasi dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit prej Institutit të Sigurimeve Shoqërore Turqi, duhet të merret me rezervë për vlerën provuese të tij. Në aspektin formal, ky dokumentacion nuk shoqërohet me vulën apostile, si dhe nuk vërteton se sa janë të ardhurat e realizuara nga personat e lidhur për periudhën 2012 - 2016. Edhe në këtë rast rezulton se Komisioni nuk ka hetuar apo të ketë kryer analizë financiare mbi të ardhurat e realizuara nga huadhënësit¹², kostot e jetesës së tyre dhe mundësinë e këtyre personave për të dhënë hua shumën prej 15.000 eurosh.
67. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, për huan si më sipër, pas paraqitjes së provave të reja nga subjekti i rivlerësimit, Komisioneri Publik u shpreh se:

67.1 *Subjekti ka depozituar dokumentacion të lëshuar nga autoritetet turke (mbi pagesën e sigurimeve shoqërore mbi të ardhurat), si dhe borderotë (provë e re) nga shoqëria " {***} ", përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Të ardhurat e pasqyruara në borderotë e shoqërisë përputhen me të ardhurat e deklaruara dhe të konfirmuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në shtetin turk.*

¹² Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016: “subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për ta justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

67.2 Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion, konstatohet se të ardhurat neto të realizuara nga personat e tjerë të lidhur, për periudhën janar 2013 - prill 2016 (pasi në maj është kryer transfertat bankare), janë në shumën 122.388 lira turke ose 4.623.800 (katër milionë e gjashtëqind e njëzet e tre mijë e tetëqind) lekë. Shuma e dhënë hua në vlerën 15.000 euro ose 54.540 lira turke (2.060.000 – dy milionë e gjashtëdhjetë mijë lekë) rezulton se zë rreth 45% të të ardhurave totale të familjes së personave të tjerë të lidhur, për periudhën 2013-2016.

67.3 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, të dhënat e referuara nga subjekti mbi limitin minimal të shpenzimeve janë në nivele tepër të ulëta për t'u konsideruar në analizën financiare të personave të tjerë të lidhur. Në rastin më të mirë, nisur nga fakti se subjekti ka provuar me dokumentacion se personat e tjerë të lidhur jetojnë në shtëpinë e të afërmeve, pa pagesë, në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpenzimet e jetesës për personat e tjerë të lidhur duhet të llogariten si një mesatare e thjeshtë aritmetike e dy niveleve të përcaktuara mbi shpenzimet e jetesës në shtetin turk.

67.4 Nga sa më sipër, duke qenë se shuma e huas së dhënë subjektit është sa rreth 45% e totalit të të ardhurave neto nga pagat e personave të tjerë të lidhur, për periudhën 2013 - 2016, rezulton se subjekti nuk ka arritur të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

68. Subjekti i rivlerësimit u mbrojt duke u shprehur në konkluzionet e tij përfundimtare në Kolegj si vijon.

68.1 Më lejoni të theksoj se për këtë shkak nuk më është kaluar barra e provës nga Komisioni në përfundim të hetimit administrativ. Por, si për të gjitha shkaqet e ankimit, dhe për këtë shkak, unë kam qenë plotësisht bashkëpunues dhe i gatshëm që të vë në dispozicion të institucioneve të vetingut të gjitha dokumentet dhe të dhënat, që të provoj në mënyrë sa më bindëse dhe shteruese aftësitë paguese të personave të tjerë të lidhur.

68.2 Ne parashtrimet e mia të datës 20.09.2019, unë kam paraqitur dokumente të marra në institucionet zyrtare dhe me vulë apostile nga shteti i Turqisë, të cilat provojnë bindshëm dhe tej çdo dyshimi burimin e ligjshëm të huave të deklaruar nga personat e tjerë të lidhur, me të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

68.3 Provohet, sikurse e pranon Komisioneri, se personat e lidhur kanë pasur të ardhura të ligjshme në shumën prej 122.388 lirash turke, për të cilat janë paguar taksat. Në fakt, të ardhurat e ligjshme janë në shumën 126.000 lira turke, pasi Komisioneri nuk ka llogaritur edhe të ardhurat deri në datën 15 maj, kur është kryer transfertat nga Turqia në Shqipëri,

68.4 Është i pashpjegueshëm fakti se përse Komisioneri e bën llogaritjen e të ardhurave të realizuara në Turqi me kursin zyrtar lekë shqiptarë - lira turke në vitin 2016, kur të ardhurat janë fituar në lira turke, është bërë këmbimi në euro në Turqi, janë dërguar në euro dhe, pa u tërhequr nga llogaria bankare, po në euro nga banka është bërë transfertat në llogarinë e shitësit të apartamentit. Ndërkohë, gjatë analizës sime në parashtrimet e datës 20.09.2019, për kryerjen e këtij veprimi unë kam përdorur kursin euro - lira turke, sipas Bankës Qendrore të Evropës, sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Evropës.

69. Kolegji konstatoi fillimisht se nga dokumentacioni i ardhur nga Komisioni, rezulton se për pasurinë apartament me sipërfaqe 78,4 m², burimet e krijimit të saj nuk janë hetuar në mënyrë shteruese. Rezultoi se dokumentet e ardhura nga Turqia nuk përmbushnin kriteret ligjore formale të parashikuara në nenin 266 të Kodit të Procedurës Civile, dhe se janë dokumente të cilat jo vetëm nuk provojnë se të ardhurat e personit tjetër të lidhur janë të ligjshme¹³, por janë administruar nga Komisioni jo në formën e parashikuar në ligj (shih paragrafin nr. 55, si në lidhje me dokumentacionin e znj. M. C. dhe kunatit, z. B. C.).
70. Kolegji riçeli hetimin gjyqësor për të hetuar faktet e pretenduara në ankim dhe i dha mundësinë subjektit të rivlerësimit të shpjegohet në lidhje me to. Pasi u morën provat e reja të sjella nga subjekti i rivlerësimit për këtë shkak, në formën e kërkuar nga ligji, dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor, Kolegji arriti në konkluzionet e mëposhtme.
71. Për përllogaritjen e shpenzimeve të jetesës së huadhënësit, z. A. M., dhe bashkëshortes së tij, znj. A. H. M., në shtetin turk u përdorën të dhënat e publikuara nga Eurostat për studimin e shpenzimeve të jetesës për një familje në kufirin e varfërisë¹⁴ në Turqi. Nga dokumentacioni i administruar në Kolegji gjatë seancave gjyqësore, u përllogaritën të ardhurat e përfituara nga z. A. M. dhe bashkëshortja e tij për periudhën dhjetor 2012 deri në muajin maj 2016, kur është dhënë huaja në vlerën 15.000 euro. Për këtë periudhë, të ardhurat neto familjare kanë qenë në vlerën 84.841,29 lira turke, të konvertuara në euro në vlerën 43.796,25 euro, me kursin e Bankës Evropiane¹⁵, sipas vitit përkatës. Shpenzimet e jetesës për këto vite sipas Eurostat, për një familje në Turqi, janë të barabarta me 14.972,33 euro. Diferenca mes të ardhurave dhe shpenzimeve për këto vite rezulton 28.823,92 euro. Për këtë arsye, sipas përllogaritjes së mësipërme, rezulton se z. A. M. dhe bashkëshortja e tij mund të kursenin vlerën e dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

71.1 Kolegji arsyetoi se pretendimi i Komisionerit Publik në lidhje me pamundësinë financiare të familjes së kunatit të subjektit të rivlerësimit sepse vlera e huas përbën 45% të të ardhurave të tyre ndër vite, nuk është i bazuar. Mundësia e huadhënies së z. A. M. dhe znj. A. H. u përllogarit duke kryer një analizë financiare midis të ardhurave të përfituara dhe shpenzimeve të jetesës të përllogaritura sipas institucioneve zyrtare në shtetin turk dhe Eurostat-it.

71.2 Kolegji, lidhur me këtë shkak ankimi në funksion të nenit F, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, korrigjoi gabimin procedural të kryer nga ana e Komisionit me administrimin e akteve për këtë shkak në kundërshtim me parashikimet ligjore, duke bërë të mundur administrimin e provave sipas kërkesave të nenit 266 të Kodit të Procedurës Civile dhe Konventës së Hagës (shih paragrafin nr. 42, si në lidhje me dokumentacionin e znj. M. C. dhe kunatit, z. B. C.).

71.3 Për më tepër, Kolegji konstatoi se subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit gjyqësor arriti të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, z. A. M. dhe bashkëshortes së tij, në kuptim të nenit 32, paragrafi 4 i ligjit nr. 84/2016, dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Dhe,

¹³ Në lidhje me jurisprudencën e Kolegjit për të njëjtat fakte, shih paragrafin 12.6 të vendimit nr. 9/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 18.04.2019: [...] trupi gjykues i Kolegjit vëren se nga ana e Komisionit nuk është kryer hetim i plotë dhe i gjithanshëm lidhur me mundësinë huadhënëse të personit tjetër të lidhur [...].

¹⁴ <https://ec.europa.eu/eurostat/web/income-and-living-conditions/data/database>

¹⁵ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/tec00033/CustomView_1/table?lang=en

duke i shtuar kësaj analize faktet e njohura në Komision (referencë te poshtëshënimi nr. 5), si faktin se huaja është transferuar nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare nga Turqia në Shqipëri dhe menjëherë kjo hua i është transferuar shitësit të apartamentit të sipërcituar, nga Kolegji vlerësohet se subjekti i rivlerësimit në këtë rast shpjegoi bindshëm mundësinë e personave të tjerë të lidhur për t'i dhënë atij huan në vlerën 15.000 euro.

Në konkluzion të analizës së këtij shkaku ankimi, Kolegji nuk e gjen të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik në lidhje me huan e marrë nga subjekti i rivlerësimit personave të tjerë të lidhur, z. A. M. dhe bashkëshortes së tij, znj. A. H. M.

72. *Lidhur me shkakun e ankimit për mosdeklarimin e pasurisë së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në bashkëpronësi me familjarët e saj të origjinës, në pjesë takuese të barabarta, e cila është fituar me ligjin 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën", Kolegji konstatoi si më poshtë.*

73. *Komisioneri Publik në ankim ka pretenduar se: Në shqyrtim të akteve të administruara, pretendimeve dhe provave të dorëzuara nga subjekti, vlerëson se arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga Komisioni se si shkak i martesës humbet të drejtat e bashkëpronësisë në tërësi nga familja bujqësore, është rrjedhojë e keqinterpretimit të ligjit civil. Nisur nga arsyetimi dhe përfundimet e Komisionit, duket sikur ky i fundit, bazuar në nenin 5/c të ligjit nr. 8337/1998 "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave", ku përcaktohet se në çastin e kalimit të pronësisë të tokës bujqësore kërkohen aktet që vërtetojnë përbërjen e familjes bujqësore, në mënyrë të gabuar, ipso jure ka zhveshur nga bashkëpronësia në tërësi e familjes bujqësore, sipas Kodit Civil, subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij, e rrjedhimisht, për qëllim të procesit të rivlerësimit ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm dhe mosdeklarimit të pasurisë, referuar nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.*

Komisioneri Publik, bazuar në aktet e administruara, vlerëson se si subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (bashkëshortja), sipas gjendjes familjare të datës 1.8.1991, kanë qenë pjesëtarë të familjeve bujqësore respektive dhe kanë përfitur tokë bujqësore sipas ligjit nr. 7501/1991, "Për tokën", regjistruar në ZVRPP-në Pogradec, me statusin "familje bujqësore".

Bazuar në nenin 222 të Kodit Civil, ata tërheqin të drejta reale pronësore mbi pasuritë e mësipërme dhe sipas nenit 4, pika 1, germa "a" e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, ata kanë pasur detyrimin ligjor t'i deklarorin këto pasuri dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil. Bashkëpronësia midis anëtarëve të familjes bujqësore paraqitet si bashkëpronësi në tërësi dhe për sa kohë nuk është bërë pjesëtimi sipas nenit 207 të Kodit Civil, ndaj saj zbatohen rregullat e përgjithshme dhe të posaçme të Kodit Civil për kryerjen e veprimeve juridike në tërësi apo dhe disponimit mbi to në veçanti.

Sipas ligjit nr. 7501/1991, ligjvënësi e njohu bashkëpronësinë mbi tokën bujqësore për të gjithë ata anëtarë të familjeve shqiptare që banonin dhe jetonin në fshat apo në ferma të ndryshme, por që ishin në përbërjen familjare të familjes bujqësore para daljes së këtij ligji, datë 19.7.1991. Pra, në këtë rast, vetëm ata persona që kishin lindur para datës 1.8.1991, kishin të drejtë të përfitonin nga dispozitat e ligjit, për t'u bërë bashkëpronarë të tokës bujqësore, e që do të përfitonin pas shpërbërjes së kooperativave dhe fermave bujqësore. Numri i anëtarëve të gjallë të familjeve bujqësore dhe rrjedhimisht numri i personave që do të ishin bashkëpronarë mbi tokën bujqësore, ishte një numër i përcaktuar me miratimin e ligjit "Për tokën" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 2.8.1991, "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore".

Në analizë literale të këtyre normave, konstatojmë se natyra e bashkëpronësisë së familjes bujqësore në këtë rast, referuar edhe nenit 222 të Kodit Civil të vitit 1994, nuk mund të ndryshojë

nën logjikën e pakësimit apo shtimit në mënyrë beneficiare, si shkak largimi apo ardhjeje të anëtarëve në familjen bujqësore nga martesat. Bashkëpronësia në tërësi e familjes bujqësore, për sa kohë nuk është pjesëtuar sipas rregullave të nenit 207 të Kodit Civil, secili prej tyre tërheq të drejta dhe detyrime ndaj asaj pasurie, qëndrim ky i konsoliduar edhe nga jurisprudenca e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Komisioneri Publik vlerëson se nuk ka asnjë rrethanë ligjore që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të të mos deklarojnë saktësisht dhe mjaftueshmërisht pasuritë e tyre në pronësi dhe bashkëpronësi. Neni D, pikat 1, 2 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit 2017, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarimin saktësisht dhe mjaftueshmërisht të “pasurisë” së tij dhe të personave të lidhur për “burimin” në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast përfshihet si origjina, pra shkak apo veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, ashtu dhe mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj. Në këtë drejtim, deklarata e pasurisë “vetting”, shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016, është mjaft e qartë kur përcakton se: “Objekti i deklarimit: Të gjitha pasuritë e akumuluar ndërr vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 e ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur. Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë të shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloji pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë”.

Bazuar në sa më sipër trajtuar, provohet se subjekti i rivlerësimit së bashku me personin e lidhur (bashkëshortja) ndodhen në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kundërshtim kjo me përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Aplikimi i nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016 gjen zbatim si pasojë e kësaj gjendjeje fakti, konstatuar gjatë hetimit administrativ për qëllim të procesit të rivlerësimit. Në këtë drejtim mbajmë në konsideratë edhe pikën 75 të vendimit nr. 07, datë 25.9.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku ndër të tjera shprehet se: “Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë, në asnjë rast nuk e lidhin pamjaftueshmërinë e deklarimit me elementet subjektive të dashjes apo qëllimit”.

Në këtë proces subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016, në pjesën informuese të deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit, subjektet janë informuar mbi sanksionet në rast mosplotësimi me saktësi dhe vërtetësi të saj. Procesi i rivlerësimit është një procedurë administrative/sanksionuese (dhe asnjëherë një proces penal), e cila ofron të gjitha garancitë e një procesi të rregullt ligjor. Në lidhje me deklarimin e pasurisë, ligji nuk ka pasur në qëllim të tij përcaktimin e rrethanave lehtësuese apo rënduese, të lidhura me dashjen apo qëllimin, pasi në të kundërt do të kishte bërë përcaktime të tilla, si në nenin 38 për standardet e kontrollit të figurës.

74. Subjekti i rivlerësimit nga ana e tij, duke iu referuar edhe konkluzioneve të Komisionit, u mbrojt duke u shprehur se:

Së pari, burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive, toka bujqësore i është dhënë familjes bujqësore të prindërve të bashkëshortes nga shteti pa shpërblim në vitin 1991, trualli 170 m² i është dhënë po familjes bujqësore të prindërve të bashkëshortes nga shteti pa shpërblim në vitin 1985 dhe banesa 100 m² është ndërtuar nga prindërit e bashkëshortes në vitin 1985. Duhet qartësuar faktin që nuk mund të pretendohet bashkëpronësia e bashkëshortes për banesën e ndërtuar në vitin 1985 nga prindërit e saj, pasi ajo ka qenë e mitur dhe nuk ka asnjë kontribut në krijimin e kësaj pasurie.

Së dyti, referenca në ligjin nr. 8337, datë 30.04.1998, "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave" dhe aktet e tjera në zbatim të tij, është e drejtpërdrejtë dhe e qartë. Injorimi i tij nga Komisioneri nuk është i drejtë. Neni 5, paragrafi "b" përcakton qartë se për kalimin e pronësisë së tokës së familjes bujqësore nevojiten: "Aktet që vërtetojnë përbërjen e familjes bujqësore në rastin e kalimit të pronësisë, të vërtetuar nga certifikata e gjendjes civile, vërtetimi i pushtetit lokal dhe deklarata e përbashkët e anëtarëve të familjes [...]". Pra, për kalimin e pronësisë së pasurive të familjeve bujqësore nevojiten të firmosin si bashkëpronarë anëtarët e tyre në momentin e shitjes. Çdo pjesëtar tjetër i larguar nga kjo familje e ka humbur njëkohësisht bashkëpronësinë. Në këto kushte, edhe bashkëshortja ime e ka humbur të drejtën e pronësisë mbi këto pasuri.

Lidhur me këto dy pasuri, pasi ka grumbulluar dhe analizuar dokumentet dhe të dhënat nga institucionet shtetërore, Komisioni ka konkluduar se: "[...] Në përfundim, duke marrë në konsideratë legjislacionin e sipërcituar, në interpretim të të cilit është e qartë se familja bujqësore është një organizim ku hyjnë dhe dalin anëtarë të cilët përfitojnë ose lëshojnë pronësi në të, në bazë të kontributeve ose të drejtave të tjera të fituara për shkak të ligjit, znj. E. M., pavarësisht se në datën 01.08.1991 ka qenë anëtare e familjes bujqësore të z. Z. M., prej vitit 1997 kur ajo është shkëputur nga kjo familje për shkak të martesës me z. Besnik Muçi, ajo nuk mund të përfitojë të drejta pronësore mbi pasuritë e kësaj familjeje bujqësore (përveç se për shkaqe ligjore, si p.sh. trashëgimia), e për rrjedhojë, si subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe znj. E. M., nuk kanë pasur detyrim ligjor për deklarimin e kësaj pasurie në ILDKPKI" (f. 30 e vendimit).

Vlerësoj të drejtë pasqyrimin dhe analizën e fakteve, analizën juridike dhe konkluzionet e arritura nga Komisioni në vendimin e tij se unë dhe bashkëshortja nuk kemi pasur detyrimin për të deklaruar këto pasuri. Të dyja këto pasuri janë pasuri të familjes bujqësore të babait të bashkëshortes dhe nisur nga fakti që bashkëshortja, si ish-pjesëtare e familjes bujqësore të babait të saj, është larguar nga kjo familje e saj prej 22 vjetësh nuk ka më të drejta pronësie.

Në këtë frymë të interpretimit të nenit 5 të ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998, "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave", ka ecur dhe praktika e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në praktikën e saj dhe në udhëzimet që u ka dhënë Zyra e Vendore të Regjistrimit të Pasurive në rastin e pronave të familjeve bujqësore.

75. Kolegji vlerëson faktin se Komisionit i ka rezultuar se këto pasuri nuk janë deklaruar ndonjëherë si në deklaratat periodike të interesave, ashtu dhe në deklaratën *vetting* nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij. Nga korrespondenca e Komisionit me Bashkinë Pogradec, Njësia Administrative {***}, konfirmohet se në certifikatën familjare të z. Z. M. (babai i bashkëshortes së subjektit), më datë 01.8.1991, në përbërjen e familjes bujqësore rezulton edhe emri i bashkëshortes së subjektit. Kjo e fundit ka përfituar tokë bujqësore sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën" (në vijim "ligji nr. 7501"), regjistruar në ZVRPP-në Pogradec, me statusin "familje bujqësore". Bazuar në nenin 222 të Kodit Civil, anëtarët e familjes bujqësore tërheqin të drejta reale pronësore mbi pasuritë e mësipërme dhe sipas nenit 4, pika 1, germa "a" e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, ata kanë pasur detyrimin ligjor t'i deklarorin këto pasuri dhe të drejtat

reale mbi to të përcaktuara nga Kodi Civil. Bashkëpronësia midis anëtarëve të familjes bujqësore paraqitet si bashkëpronësi në tërësi dhe, për sa kohë nuk është bërë pjesëtimi sipas nenit 207 të Kodit Civil, ndaj saj zbatohen rregullat e përgjithshme dhe të posaçme të Kodit Civil për kryerjen e veprimeve juridike në tërësi apo dhe disponimit mbi to në veçanti.

76. Sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, ligjvënësi e njohu bashkëpronësinë mbi tokën bujqësore për të gjithë ata anëtarë të familjeve shqiptare që banonin dhe jetonin në fshat apo në ferma bujqësore, por që ishin në përbërje të familjes bujqësore. Personat që kishin lindur para datës 01.8.1991, kishin të drejtë të përfitonin nga dispozitat e ligjit, për t’u bërë bashkëpronarë të tokës bujqësore, e që do të përfitonin pas shpërbërjes së kooperativave dhe fermave bujqësore. Numri i anëtarëve të gjallë të familjeve bujqësore dhe rrjedhimisht numri i personave që do të ishin bashkëpronarë mbi tokën bujqësore, ishte një numër i përcaktuar me miratimin e ligjit “Për tokën” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”. Në analizë literale të këtyre normave, konstatohet se natyra e bashkëpronësisë së familjes bujqësore në këtë rast, referuar edhe nenit 222 të Kodit Civil të vitit 1994, nuk mund të ndryshojë nën logjikën e pakësimit apo shtimit në mënyrën që pretendon subjekti i rivlerësimit. Bashkëpronësia në tërësi e familjes bujqësore, për sa kohë nuk është pjesëtuar sipas rregullave të nenit 207 të Kodit Civil, secili prej tyre tërheq të drejta dhe detyrime ndaj asaj pasurie.
77. Personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit Besnik Muçi, nuk ka deklaruar pasuritë e saj në bashkëpronësi. Neni D, pikat 1, 2 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit 2017, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarimin saktësisht dhe mjaftueshmërisht të “pasurisë” së tij dhe personave të lidhur për “burimin” në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast përfshihet si origjina, pra shkaku apo veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, ashtu dhe mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj.
78. Në këto rrethana faktike, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të paplotë për kriterin e pasurisë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, paragrafët 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Kolegji këtë pasaktësi, nëse do ishte e vetme në deklarimin e subjektit të rivlerësimit, vlerëson se nuk do të sillte automatikisht shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Në vlerësimin tërësor të procedurave, aplikimi i nenit 61, paragrafi 5 i ligjit nr. 84/2016, gjen zbatim si pasojë e kësaj ndërvarjeje midis rrethanave faktike dhe ligjore të konstatuara si gjatë hetimit administrativ në Komision, por edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, në vlerësimin tërësor për qëllim të procesit të rivlerësimit.
79. Sa më sipër, Kolegji çmoi se kërkimi i Komisionerit Publik në lidhje me mosdeklarimin e pasurisë së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në bashkëpronësi me familjarët e saj të origjinës, është i drejtë dhe duhet pranuar dhe vlerësuar. Dhe, nga ana tjetër, çmohet se prapësimi dhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë shkak ankimi është i pabazuar në ligj e në prova dhe, për rrjedhojë, edhe konkluzioni i Komisionit për këtë fakt është i gabuar.
80. *Në lidhje me shkakun e ankimit mbi mosmbulimin e shpenzimeve vjetore të subjektit nga të ardhura të ligjshme për vitet 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2016, Kolegji konstaton si më poshtë.*
81. Komisioneri Publik, në ankim ka pretenduar se: *Konkluzioni përgjithësues i Komisionit, mbi intensitetin e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit, nuk gjen asnjë mbështetje ligjore, pasi në*

një ekonomi familjare të ardhurat e ligjshme duhet të mbulojnë në çdo rast shpenzimet e kryera për konsum, kursime dhe investime/pasuri. Ky është dhe qëllimi i dispozitës kushtetuese, neni D/3, kur shprehet se: “subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave”, në të kundërt, nëse raporti i ligjshmërisë së të ardhurave me shpenzimet, kursimet apo investimet e kryera do të ishte i zhdrejtë, atëherë rrjedhimisht do të gjente zbatim neni 61/3 i ligjit nr. 84/2016, pra subjekti do të gjendej në situatën e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurisë së tij.

Sa më sipër, provohet se për vitet 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2016, subjekti nuk mbulon shpenzimet dhe kursimet me të ardhura të ligjshme. Si rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, duke rezultuar kështu për këto vite me pasuri apo të ardhura më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht sipas nenit D/3, të Aneksit të Kushtetutës.

82. Komisioni në lidhje me faktet e trajtuara në këtë shkak ankimi në vendim objekt shqyrtimi, është shprehur se: *Ka pasaktësi të vogla në plotësimin e deklaratave të ligjshme, balancat financiare negative ndër vite janë të papërfillshme në lidhje me intensitetit e të ardhurave dhe të shpenzimeve të kryera; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit. Sipas Komisionit, subjekti ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas parashikimeve të nenit 59/1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.*

83. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi është mbrojtur, duke u shprehur në Kolegj, ndër të tjera, në konkluzionet përfundimtare se:

U provua me provat dhe argumentet e paraqitura, si dhe të dhënat zyrtare të marra nga ILDKPKI-ja dhe INSTAT¹⁶-i, të përdorura nga institucionet e vetingut (Komisioni dhe Komisioneri) në të gjitha vendimmarrjet e tyre, se për vitet 2003, 2004, 2005 dhe 2006, që jo vetëm nuk kam diferenca negative, por për vitet 2003, 2004 dhe 2005 bilanci është pozitiv në shumën 210000 lekë.

Duke iu referuar qëndrimeve të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit shprehet se:

Së pari, është shkëlqe e pastër e parimit kushtetues të barazisë para ligjit, pasi ka pranuar faktin që metodologjia dhe rezultatet e dala lidhur me shpenzimet e jetesës për mua janë të ndryshme nga metodologjia dhe rezultatet e dala për kolegët e mi, subjekte të rivlerësimit. Vetë Komisioneri nuk shpjegon se cila ka qene metodologjia që ai ka përdorur për llogaritjen e shpenzimeve familjare me të cilat unë paskam qenë dakord. Argumenti i komisionerit se një institucion kushtetues, Komisioneri Publik në këtë rast, mund të mbajë një qëndrim në kundërshtim me Kushtetutën, neni 18/1, dhe ligjin nr. 84/2016, neni 4, paragrafi 5, vetëm se shtetasi ndaj të cilit zbatohet ligji ose Kushtetuta, subjekti i rivlerësimit në këtë rast, nuk e kundërshton këtë qëndrim, është në shkëlqe të parimit kushtetues që të gjithë janë të barabartë para ligjit. Fakti që unë nuk e paskam kundërshtuar metodologjinë dhe rezultatet e dala lidhur me shpenzimet e jetesës, i lejon Komisionerit të pranojë publikisht që për mua të përdoret një metodologji për llogaritje e shpenzimeve të jetesës e ndryshme nga ajo e përdorur për subjektet e tjera të rivlerësimit.

Së dyti, nuk është i vërtetë fakti i pretenduar nga Komisioneri se unë nuk e paskam kundërshtuar metodologjinë dhe rezultatet e dala lidhur me shpenzimet e jetesës së familjes sime. Në parashtrimet e datës 20.09.2019, pikat 4.7.3 dhe 4.7.4 qartësisht kam kundërshtuar metodologjinë dhe rezultatet e hetimit administrativ për diferencat e mësipërme. Kam theksuar që jo vetëm gjatë atyre viteve, por edhe aktualisht ne nuk kemi një rregullim ligjor lidhur me kontabilitetin apo

¹⁶ Instituti i Statistikave.

buxhetin familjar dhe shpenzimet për jetesë. Ndaj dhe të vetmet të dhëna zyrtare për këtë fakt i ka INSTAT-i, të cilave unë do t'u referohem më poshtë gjatë analizës sime.

Së treti, Komisioneri në zbatim të nenit C/2 dhe nenit 15/2 të Kushtetutës, para se të mbante këtë qëndrim publik, duhej të kishte bërë një analizë të fakteve të pretenduara nga unë, duke marrë parasysh dhe qëndrimin e tij në të gjitha rastet e tjera. Duke pasur në konsideratë qëndrimin e mësipërm të Komisionerit në seancën e datës 07.11.2019, unë kam paraqitur një analizë të hollësishme, lidhur me diferencat negative të këtyre viteve, mbështetur në të dhënat e referuara nga ILDKPKI-ja dhe INSTAT-i. [...] Në parashtrimet e mia të datës 20.09.2019 kam shpjeguar se gjatë këtyre viteve, veç pagesës së qirasë, shpenzimet e tjera në familje kanë qenë të kufizuara. Fëmijët kanë qenë të vegjël dhe kemi kryer vetëm shpenzime të nevojshme për jetesë (nuk kemi pasur mjete motorike në pronësi apo përdorim, kemi përdorur shërbimet publike për transport, nuk kemi kryer pushime, nuk kemi udhëtuar asnjëherë jashtë Republikës së Shqipërisë). Po ashtu, duke qenë familje e re, jemi ndihmuar nga familja e prindërve të mi dhe nga familja e prindërve të bashkëshortes [...]. Në vijim të argumenteve të paraqitura në parashtrim, do të dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj dhe të argumentoj që kjo balancë negative në vlera të vogla është edhe si rezultat i përcaktimit të shpenzimeve për jetesë në analizën financiare të kryer nga Komisioni në një nivel më të lartë sesa realisht duheshin përlllogaritur. Shpenzimet mesatare për jetesë të llogaritura nga KPK-ja për vitet 2003, 2004, 2005, 2006, e në vijim deri në vitin 2012, janë përcaktuar në një shifër fikse 600.000 lekë në vit për 4 persona, pra 150.000 lekë për person në vit. Nga viti 2013 dhe deri në vitin 2016, ato janë në shumën 750.000 lekë në vit.

Subjekti i rivlerësimit, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, kundërshtoi metodologjinë e shpenzimeve për jetesë të përdorur nga Komisioni dhe, për këtë shkak, paraqiti shkresën me nr. {***} prot., datë 29.10.2019, të ILDKPKI-së në përgjigje të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, datë 25.10.2019, duke u shprehur se:

Vendosja e shpenzimeve më të larta në vitet e para, kur të ardhurat janë më të ulëta, rrjedhimisht të çon në një raport të pafavorshëm, i cili mund të paraqesë një diferencë negative. Konkretisht, në vitin 2003, të ardhurat nga paga ime janë 642.156 lekë, në vitin 2004 janë 806.657 lekë dhe në vitin 2005 janë 787.398 lekë. Përballja e të ardhurave më të ulëta në vitet e para me të njëjtin nivel shpenzimesh paraqet një situatë joreale të familjes sime. Shpenzimet në përgjithësi janë të lidhura në raport me të ardhurat e siguruar. Në një situatë me të ardhura më të larta, çdo familje mund t'i lejojë vetes edhe shpenzime më të larta, me të ardhura të limituara, sigurisht që edhe shpenzimet do të jenë më të kufizuara, për këtë arsye them që vendosja e shpenzimeve më të larta në atë periudhë ka pasur ndikimin e vet në diferencën negative.

Subjekti i rivlerësimit në mbështetje të pretendimeve të tij, përveç sa më sipër, paraqiti një analizë financiare në mbështetje të prapësimeve të tij ndaj ankimit. Analiza financiare e subjektit të rivlerësimit konfirmonte diferencën negative të vogël vetëm për vitin 2006 në shumën 44.053 lekë. Me këtë analizë financiare të tijën, subjekti i rivlerësimit për herë të parë në Kolegj kundërshtoi analizën financiare të Komisionit, që ka përdorur si shpenzime vjetore nga viti 2003 deri në vitin 2006, shumën fikse prej 150.000 lekësh në vit për person.

84. Kolegji, në vlerësim të shkakut të ankimit të mësipërm dhe të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, bazuar në aktet e administruara nga Komisioni për këtë shkak, lidhur me analizën ekonomiko-financiare për subjektin e rivlerësimit Besnik Muçi dhe personat e lidhur me të, pasi mori në shqyrtim edhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të shtimit të të ardhurave dhe reduktimit të shpenzimeve të përlllogaritura, vlerësoi sa vijon.

84.1 Komisioneri Publik në ankimin e tij, analizën financiare e mbështet në një metodologji të përdorur nga Komisioni, sipas së cilës për periudhën kohore 2003-2012, shpenzimet për jetesën për subjektin e rivlerësimit llogariten në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë për një përbërje familjare prej 4 personash, ndërsa nga viti 2013 deri në vitin 2016 shpenzimet e jetesës për subjektin e rivlerësimit për një përbërje familjare prej 5 personash, përllogariten në vlerën 750.000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Totali i shpenzimeve të jetesës për periudhën 2003-2016 rezulton 9.000.000 lekë, e barabartë me shumën e përcaktuar nga ILDKPKI-ja në aktin e kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë të subjektit të rivlerësimit Besnik Muçi. Ndërsa subjekti i rivlerësimit e prapësoi këtë analizë në Kolegj, duke iu referuar një shkrese të ILDKPKI-së, e cila përcakton se shpenzimet për jetesën në vitin 2003 përcaktohen në vlerën 434.016 lekë, në vitin 2004 në vlerën 434.016 lekë, në vitin 2005 në vlerën 567.072 lekë, në vitin 2006 në vlerën 567.072 lekë. Përcaktimi i shpenzimeve të jetesës nga ILDKPKI-ja është kryer duke u bazuar në të dhëna të marra nga Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF 2000), Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS 2002), Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF 2006-2007), Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS 2008), Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ 2012), Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF 2014), Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF 2015), Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF 2016).

84.2 Kolegji, pasi shqyrtoi aktet e administruara nga Komisioni, pretendimet e Komisionerit Publik dhe provat, prapësimet e pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me sa më sipër, kreu analizën e tij financiare. Nëse do të konsideronim kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të përllogaritur shpenzimet e jetesës sipas shkresës me nr. {***} prot., datë 29.10.2019, e ILDKPKI-së në përgjigje të kërkesës së subjektit të rivlerësimit të datës 25.10.2019, nga analiza ekonomiko-financiare do të rezultonte një diferencë pozitive midis të ardhurave dhe shpenzimeve për vitet 2003 dhe 2004, por përsëri do të rezultonte diferencë negative midis të ardhurave dhe shpenzimeve për vitet 2005, 2006 dhe 2016, duke e vënë subjektin në pamundësi për të mbuluar shpenzimet e jetesës me burime të ligjshme për këto vitet e fundit.

Analiza e mësipërme tregon se me të gjitha metodat e përllogaritjes së shpenzimeve të jetesës, si ato të pretenduara nga subjekti, si ato të përdorura nga Komisioni dhe Komisioneri Publik dhe me metodat e publikuara nga INSTAT-i për përllogaritjen e shpenzimeve të jetesës, të cilat zbatohen nga ILDKPKI-ja, subjekti i rivlerësimit nuk mund të mbulojë shpenzimet e jetesës me burime të ligjshme për vitet 2005, 2006 dhe 2016.

84.3 Kolegji, në vlerësim të të gjitha pretendimeve të subjektit, duke pasur parasysh edhe sa më sipër analizën e kryer në Kolegj, vëren se ky argument nuk është bindës, pasi është ngritur nga subjekti vonë në proces, për herë të parë në Kolegj në seancën gjyqësore të datës 04.11.2019, dhe ndërkohë ka folur për regjim të rreptë kursimi, të mbetur në nivel deklarativ, që herë pas here kapërcen edhe kufijtë minimalë të shpenzimeve të jetesës, të përllogaritura nga institucionet eksperte në vlerësimin e shpenzimeve në Republikën e Shqipërisë (INSTAT).

84.4 Kolegji, në vlerësim të shkakut të ankimit të mësipërm, shqyrtoi të gjithë skenarët e mundshëm të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit. Dhe si më sipër rezulton nga analizat financiare të pasqyrave të gjithë skenarëve të pretenduar, subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë negative në disa vite. Kolegji e vlerëson pretendimin e subjektit të rivlerësimit për t'u përdorur shpenzimet e jetesës sipas shkresës së ILDKPKI-së, të paraqitur si provë, si një përpjekje të tij për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij, duke pretenduar diferenca të vogla negative në vitin 2005,

sipas shkresës së ILDKPKI-së, por nuk shpjegon diferencat e tjera negative të viteve 2006 dhe 2016, sipas po kësaj shkrese të pasqyruar në analizat e mësipërme.

84.5 Edhe pse të gjitha analizat financiare, qoftë edhe sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, e nxirrnin me diferenca negative ndër vite atë, Kolegji, si i vetmi organ gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit, në funksion të nenit F¹⁷, paragrafi 1 i Aneksit të Kushtetutës, duhet të shprehet për atë që kërkohet dhe gjithçka që kërkohet në ankim dhe kjo në funksion të nenit 6¹⁸ të Kodit të Procedurës Civile, çmoi se kërkimi i Komisionerit Publik në lidhje me mosmbulimin e shpenzimeve vjetore për vitet 2003, 2004, 2005 dhe 2006 të subjektit të rivlerësimit me të ardhura të ligjshme, është i drejtë dhe duhet pranuar. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, bazuar në standardet e shpenzimeve të jetesës të vendosura në Komision dhe të përdorura edhe nga Komisioneri Publik, subjekti i rivlerësimit rezultoi me një diferencë negative midis të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2003, në vlerën 102.844 lekë; për vitin 2004 në vlerën 123.343 lekë; për vitin 2005 në vlerën 199.944,33 lekë, për vitin 2006 në vlerën 1.519.152,26 lekë.

Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, bazuar në shpenzimet e jetesës sipas shkresës së ILDKPKI-së të përmendur më sipër, të dhënat e subjektit të rivlerësimit rezultuan me diferencë negative në vitin 2005 në vlerën 38.184,33 lekë; në vitin 2006 në vlerën 1.195.576,59 lekë dhe në vitin 2016 në vlerën 58.056,2 lekë. Në të dyja analizat ekonomike nuk janë përfshirë të ardhurat nga huadhëniet e babait, xhaxhait, motrës dhe kunatit të subjektit në vitin 2006, sepse sipas analizës së mësipërme nuk mund të justifikohen me burime të ligjshme. Dhe, nga ana tjetër, çmohet se prapësimi dhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë shkak ankimi është i pabazuar në ligj e në prova dhe, për rrjedhojë, edhe konkluzioni i Komisionit për këtë fakt është i gabuar.

D. Mbi pretendimet e Komisionerit Publik dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me informacionin e përcjellë nga DSIK.

85. *Lidhur me informacionin e përcjellë nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Komisionerit Publik më datë 16.11.2018, Kolegji konstaton si më poshtë.*
86. *Komisioneri Publik në parashtrimet e tij që mbajnë datën 03.09.2019, por të depozituara në Kolegj më datë 20.09.2019, pasi u shpreh se u qëndron shkaqeve të ankimit, çmoi të sjellë në vëmendje të Kolegjit dhe kërkoi të vlerësohet si provë një informacion i përcjellë nga ai më datë 16.11.2018 nga DSIK-ja, të cilin e konsideroi sekret shtetëror dhe pretendoi se faktet dhe rrethanat e paraqitura në të, së bashku me provat dhe shpjegimet e subjektit të administruara për këtë qëllim, mund të shërbejnë në vlerësimin tërësor të çështjes.*
87. *Subjekti i rivlerësimit, gjatë debatit gjyqësor për këtë informacion, ndër të tjera u shpreh se : Nga administrimi i Informacionit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe hetimit gjyqësor të kryer nga Kolegji, nuk rezultoi asnjë e dhënë apo dyshim që mund të cenonte figurën apo situatë konflikti interesi. Komisioneri deklaroi në seancë se ky informacion nuk ka lidhje me asnjë nga shkaqet e ankimit dhe me tri kriteret e vlerësimit dhe, në këto kushte, Kolegji kryesisht vendosi administrimin e tij. Po ashtu, në datën 16.10.2019, theksoi se fakti që shtetasit*

¹⁷ Kolegji i Apelit përbëhet nga shtatë gjyqtarë dhe është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit, sipas këtij Aneksi dhe ligjit. Kolegji vendos në trupa gjykuese me pesë anëtarë secili.

¹⁸ Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.

A. L. unë i kam pasur në vitin 2016 një hua prej 21.000 eurosh, sipas kontratës noteriale të shitjes së pasurisë së paluajtshme me kusht, mund të shërbejë si rrethanë dhe si argument që unë mund të vihem lehtësisht nën presionin e strukturave kriminale, sipas nenit 37, germa "c" e ligjit nr. 84/2016. Të gjitha këto pretendime janë jashtë objektit të ankimit. Qëndrimi i Komisionerit Publik që unë mund të vihem lehtësisht nën presionin e strukturave kriminale, për shkak se i kam pasur në vitin 2016 një hua prej 21.000 eurosh, sipas një kontrate noteriale shtetasit A. L., të proceduar penalisht për moskallëzim krimi, është në kundërshtim me ligjin.

88. Kolegji, pasi e administroi këtë informacion si provë dhe ia nënshtroi debatit gjyqësor së bashku me provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, i shqyrtoi dhe vlerësoi rrethanat e pasqyruara në të, që kishin të bënin me marrëdhënien shoqërore të posaçme me individin A. L., për të cilin subjekti e dinte se ishte përfshirë në konflikte fizike me individë të tjerë, ku është përdorur edhe armë zjarri, fakt që nga burime të hapura të informacionit rezulton të jetë bërë i njohur edhe për publikun e gjerë nga mediat, dhe që ky person ishte proceduar dhe dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 27.03.2014, për kryerjen e veprës penale të “Moskallëzimit të krimit”, vendim i cili është prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. {***}, datë 08.04.2015, duke pushuar çështjen penale në ngarkim të shtetasit A. L.. Faktin e marrëdhënies shoqërore të posaçme me individin A. L., Kolegji e gjeti të pohuar nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe të njohur gjithashtu edhe nga Komisioni, ku në faqen nr. 25 të vendimit të tij citohet se: *Subjekti, në përgjigjen e tij, protokolluar në Komision me nr. {***}¹⁹ prot., datë 20.04.2018, sqaron se e njeh dhe ka marrëdhënie shoqërore me shtetasin A. L. sepse vijnë të dy nga Pogradeci, por deklaroi se nuk ka marrëdhënie biznesi dhe nuk ka qenë ndonjëherë në kushtet e konfliktit të interesit me këtë person.*
89. Kolegji, në analizë të faktit të marrëdhënies shoqërore me individin A. L., krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni më parë se ky individ ishte përfshirë në konflikte fizike me individë të tjerë ku ishte përdorur edhe armë zjarri, fakt që nga burime të hapura të informacionit, rezulton të jetë bërë i njohur edhe për publikun e gjerë nga mediat. Në kuptim të nenit 49, paragrafi 3 i ligjit nr. 84/2016, Kolegji nuk i besoi subjektit të rivlerësimit dhe në përgjigje²⁰ të pyetjes së Kolegjit në seancën gjyqësore të datës 04.11.2019, subjekti deklaroi se nuk ka qenë në dijeni në kohë dhe hapësirë për këtë fakt të njohur për publikun.
90. Në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë me nr. {***}, datë 08.04.2015, të paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit (shih paragrafin 22.15) rezulton në pjesën “{***}” të faqes nr. 5 të tij të jetë cituar, ndër të tjera, se individi A. L. është përfshirë në një konflikt fizik për motive pronësie, ku është përdorur edhe armë zjarri.
91. Kolegji e çmoi këtë vendim të Gjykatës së Apelit Tiranë, në cilësinë e provës, dhe faktet e cituara në të i vlerëson të rëndësishme në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit.

¹⁹ Shkresa me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me individin A.L. gjendet në dosjen e ardhur nga Komisioni në fashikullin nr. 1, faqja 52 e fashikullit, faqja 5 e materialit prej 13 faqesh, me titull: “Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pyetje subjektit të rivlerësimit Besnik M. Muçi”, datë 19.04.2018.

²⁰ Pyetjes së Kolegjit, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur: “Unë kam rënë në dijeni të faktit që ky shtetas ka qenë i përfshirë në këto procedime penale vetëm kur kam marrë informacionin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe më pas kur kam komunikuar, kur ky shtetas ka ngarkuar të dorëzoj, pasi i është lakuar emri në media atë ditë, disa media e kanë lakuar edhe me emër. Ai sot që flasim ne, është një nga tatimpaguesit e mëdhenj të Bashkisë së Tiranës dhe nga punëdhënësit më të mëdhenj, si biznesmen domethënë i Bashkisë Tiranë dhe ka kërkuar që unë të paraqes këto dokumente pranë jush”.

Sjelljen e subjektit të rivlerësimit në raport me individin A. L. duke krijuar, pak kohë pas këtyre ngjarjeve si më sipër cituar, edhe marrëdhënien juridike me të, nëpërmjet kontratës noteriale të shitjes së pasurisë së paluajtshme me kusht të vitit 2016, Kolegji e vlerëson për shkak të kërkesave të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, këtë sjellje të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrën, Kolegji e vlerëson të tillë që do të duhej të ishte e pranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit të rivlerësimit, si një funksionar i denjë i atij sistemi.

92. Kolegji konsideroi edhe faktin e privilegjeve të përfituara prej subjektit të rivlerësimit në blerjen e apartamentit me sipërfaqe 78,4 m², me vendndodhje në Tiranë, Rruga e {***}, nga individi A. L. në cilësinë e shitësit dhe administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK. Ky fakt rezultoi i provuar gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, nga provat e administruara në Komision, por edhe në Kolegji, ku sipas kontratës së shitjes me rezervë të lidhur para noterit publik D. B. P. me nr. {***}, rep., dhe nr. {***}, kol., të datës 13.05.2016, subjektit të rivlerësimit pas nënshkrimit të kësaj kontrate i ka mbetur pa likuiduar vlera prej 35.000 eurosh.
93. Privilegj e konsideroi Kolegji faktin se z. A. L., si administrator i vetëm i “{***}” ShPK, rreth dy muaj para se t’ia shiste subjektit të rivlerësimit apartamentin e sipërcituar, ia ka blerë në vlerën 74.500 euro shitëses, znj. E. Sh., me aprovimin e bashkëshortit të saj, z. G. H., pra 500 euro më pak nga vlera që ia ka shitur subjektit (shih kontratën nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 08.03.2016). Kolegji, duke e vlerësuar këtë fakt privilegj, ka parasysh logjikën e veprimeve financiare që duhet të kryejë një subjekt tregtar në fushën e ndërtimit, ku në rastin konkret ka rezultuar se z. A. L., në cilësinë e administratorit të vetëm, të një shoqërie ndërtimi, duke investuar vlerën prej 74.500 eurosh në vitin 2016 për të fituar 500 euro, nuk rezulton logjike në kuptimin ekonomik-financiar. Dhe për më tepër, gjatë kësaj kohe, të presë mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për t’ia likuiduar diferencën e papaguar prej 35.000 eurosh deri në maj të vitit 2019, një pjesë të së cilës rezultoi se subjekti i rivlerësimit e likuidoi gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje.
94. Kolegji, në funksion të kërkesave të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përsëri ka parasysh në lidhje me sa më sipër dhe vlerëson përpjekjen e subjektit për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të tij apo të personave të lidhur dhe deklaratimet e pavërteta të subjektit të rivlerësimit në kuadër të bashkëpunimit, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit në lidhje me mosdeklarimin e pasurisë së bashkëshortes së tij, gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegji u shpreh se: *sipas legjislacionit shqiptar mbi regjimin juridik të pronës së familjes bujqësore prej martesës e ka humbur të drejtën e pronësisë mbi këto prona [...]. Lidhur me pasuritë e familjes bujqësore të bashkëshortes, vlerësoj se nuk rezultoi i provuar fakti i mosdeklarimit të tyre, pasi, sipas legjislacionit shqiptar që rregullon regjimin juridik të kësaj lloji pasurie, nenit 5 të ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998, "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave", bashkëshortja e ka humbur këtë pronësi duke u larguar nga familja me martesë [...].* Kolegji e gjen me vend të theksojë faktin se legjislacioni shqiptar nuk parashikon, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, humbjen e pronësisë së anëtarit të familjes bujqësore për shkak të martesës. Shpjegimin e subjektit të rivlerësimit në lidhje me mosdeklarimin e pasurisë së bashkëshortes së tij, Kolegji e vlerëson si përpjekje të tij për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë e tij apo të personave të lidhur. Gjithashtu, në analizimin e provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, konstatoi një pasaktësi në deklaratën me shkrim

dore të z. H.M., që mban datën janar 2006 dhe ku specifikohet se ky i fundit i ka dhënë subjektit të rivlerësimit në janar të vitit 2006, 3.000 euro borxh nga puna e tij dhe e djalit në emigrim dhe se këto para i janë kthyer në vitin 2008. Pyetjes së Kolegjit në lidhje me këtë pasaktësi, subjekti i rivlerësimit nuk i dha një përgjigje bindëse dhe, për rrjedhojë, Kolegji e vlerësoi si përpjekje të tij për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë e tij.

95. Përveç sa më sipër, Kolegji, gjatë shqyrtimit gjyqësor, krijoi bindjen mbi deklaratimet e pavërteta të subjektit të rivlerësimit në lidhje me dijeninë e tij për faktin se shtetasi A. L. ishte përfshirë në konflikte fizike me individë të tjerë, fakt i cili rezultoi në jetë bërë i njohur edhe për publikun e gjerë nga mediat. Për rrjedhojë, Kolegji deklarimin e subjektit të rivlerësimit se për këtë fakt erdhi në dijeni nëpërmjet informacionit të DSIK-së, e konsideron të pavërtetë.
96. Kolegji e bëri shqyrtimin e vendimit të Komisionit që i përket subjektit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik, si institucion që legjitimohet nga neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, për të vënë në lëvizje Kolegjin, duke pasur parasysh qëllimin e ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në dispozitat kushtetuese për rivlerësimin kalimtar, të të gjitha subjekteve për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë dhe rikthimin e besimit të publikut në institucionet e këtij sistemi. Si rrjedhojë, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës, procesit të rivlerësimit i nënshtrohen të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Shqipërisë. Në këto kushte, subjekti filloi procesin e rivlerësimit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë dhe përfundoi këtë proces pas emërimit të tij si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.
97. Subjekti i rivlerësimit kaloi procesin e verifikimit të kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi (në vijim “KED”), bazuar në nenin 149/d të Kushtetutës dhe nenin 237 të ligjit nr. 115/2016. KED-ja, me vendimin nr. 72, datë 24.07.2019, ka vendosur lejimin e kandidimit të subjektit të rivlerësimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Kolegji sjell në vëmendje se nëpërmjet këtij vendimi të KED-së, rezultoi që subjekti është vënë në dijeni se ai është njëherazi edhe subjekt rivlerësimi në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pavarësisht se ai është konfirmuar në detyrë nga Komisioni me vendimin nr. 58, datë 01.08.2018, dhe ndërkohë Komisioneri Publik ka paraqitur ankim ndaj vendimit të sipërcituar të Komisionit dhe çështja është në shqyrtim pranë Kolegjit. Si rrjedhojë, procesi i vlerësimit dhe pikëzimit nga KED-ja, për kandidatët për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, që vijnë nga sistemi i drejtësisë, nuk përbën rivlerësimin e subjekteve në kuptim të ligjit nr. 84/2016 dhe Aneksit të Kushtetutës.
98. Ndryshimet kushtetuese parashikuan që në sistemin e drejtësisë do të vijonin të ishin pjesë gjyqtarët dhe prokurorët, të cilët kalonin me sukses procesin e rivlerësimit. Po ashtu, fryma e Kushtetutës dhe e ndryshimeve në ligjin për Gjykatën Kushtetuese kërkon që edhe kandidatët për gjyqtarë kushtetues duhet të jenë individë që plotësojnë kriteret kushtetuese dhe ligjore, të cilët nëse vijnë nga sistemi i drejtësisë duhet të kenë një vendim të formës së prerë në kuadër të procesit të rivlerësimit, për konfirmimin e tyre në detyrë. Ndërsa për kandidatët për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese që vijnë jashtë sistemit të drejtësisë, sipas nenit 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe neneve 235, 236, 240 të ligjit nr. 115/2016, parashikohet nënshtimi i tyre në një proces të posaçëm vlerësimi për pasurinë, integritetin dhe aftësinë profesionale dhe morale që kryhet nga KED-ja me ndihmën e organeve përkatëse.

1. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, bazuar në analizën e mësipërme, arrin në këto konkluzione:

1.1. Lidhur me shkaqet e ankimit mbi pasurinë “Apartament me sipërfaqe 57 m², me adresë: rruga “{***}”, Tiranë, blerë me kontratën noteriale të shitblerjes, datë 07.01.2006, me vlerë 1900.000 lekë”, për krijimin e së cilës Komisioneri Publik pretendon se, referuar kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, përfundimet e Komisionit nuk janë në pajtueshmëri me aktet dhe provat e administruara, pasi subjekti dhe personat e lidhur me të nuk arrijnë të justifikojnë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme të të ardhurave për të kursyer në fund të vitit 2005 dhe nuk arriti të justifikojë ligjshmërinë e burimeve të huave, deklaruar të marra nga babai dhe vëllai, xhaxhai, motra dhe bashkëshorti i saj, për krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

Në konkluzion, trupi gjykues çmon se subjekti është në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e kontrollit të pasurive, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b”, dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sa i takon pasurisë së përshkruar më sipër.

1.2. Lidhur me shkakun e ankimit mbi mosdeklarimin nga subjekti në deklaratën *vetting* të pasurisë në bashkëpronësi të personit të lidhur me familjen e saj bujqësore, ku Komisioneri Publik pretendon se si subjekti, ashtu edhe personi i lidhur me të (bashkëshortja), sipas gjendjes familjare të datës 01.08.1991, kanë qenë dhe janë pjesëtarë të familjeve bujqësore respektive dhe kanë përfituar tokë bujqësore sipas ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”, regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Rrethit Pogradec, me statusin “familje bujqësore” dhe kanë pasur detyrimin ta deklarojnë këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasurinë në kundërshtim me kërkesat e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, në kuptim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e deklarimit të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë.

1.3. Lidhur me shkakun e ankimit mbi mosmbulimin e shpenzimeve vjetore për vitet 2003, 2004, 2005 dhe 2006 të subjektit me të ardhura të ligjshme, trupi gjykues vlerëson se sipas analizës financiare, rezulton se subjekti nuk mund të mbulonte shpenzimet e këtyre viteve me të ardhura të ligjshme, duke krijuar pasuri apo të ardhura më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Për pasojë, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

1.4. Lidhur me informacionin e përcjellë nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, ku Komisioneri Publik pretendon se faktet dhe rrethanat e paraqitura në të, së bashku

me provat dhe shpjegimet e subjektit të administruara për këtë qëllim, mund të shërbejnë në vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues vlerëson se:

- fakti i marrëdhënies shoqërore të posaçme me individin A.L., për të cilin subjekti dinte se ishte përfshirë në konflikte fizike me individë të tjerë ku është përdorur edhe armë zjarri, fakt që nga burime të hapura të informacionit rezulton të jetë bërë i njohur edhe për publikun e gjerë nga mediat, dhe që ky person ishte proceduar dhe dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. {***}, datë 27.03.2014, për kryerjen e veprës penale të “Moskallëzimit të krimit”, vendim i cili është prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendim nr. {***}, datë 08.04.2015, duke pushuar çështjen penale në ngarkim të A.L.;
- privilegjet e përfituara prej subjektit në blerjen e apartamentit me sipërfaqe 78,4 m² me vendndodhje në Tiranë, Rruga e {***} nga ky individ;
- favoret e përfituara në mënyrën e likuidimit të vlerës së këtij apartamenti përkundër pamundësisë reale të subjektit për ta shlyer brenda tri viteve, sipas kushteve të kontratës së shitblerjes me burimet nga paga;
- shlyerja e vlerës së mbetur të çmimit të këtij apartamenti gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj;
- përpjekja e subjektit për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të tij dhe deklaratimet e pavërteta të subjektit në kuadër të bashkëpunimit me Kolegjin, i cili, në marrjen e vendimit, mban parasysht gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016;

– nga tërësia e këtyre fakteve, konsiderohet se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në zbatim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Përfundimet e mësipërme u vlerësuan nga trupi gjykues të mjaftueshme për të konkluduar mbi kriterin e kontrollit të pasurisë së subjektit. Nisur nga sa më sipër, konsiderohet se faktet e çështjes janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Besnik Muçi nuk mund të gëzojë besimin e publikut për të qëndruar në detyrë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

2. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues, bazuar në përfundimet e mësipërme, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 33, pika 5, shkronjat “a”, “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016; dhe në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe, për pasojë, vendimi nr. 58, datë 01.08.2018, i Komisionit duhet ndryshuar, pasi nuk gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte, prova dhe ligj.

3. Për rrjedhojë, kërkimi i Komisionerit Publik për ndryshimin e vendimit nr. 58, datë 01.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 58, datë 01.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Besnik Muçi, prokuror në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit, gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese në momentin e shpalljes së këtij vendimi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
U shpall sot, më datë 21.11.2019, ora 11:00, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATOR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi